




Gëzuar Vitin e Ri 2026!

SHOQATA BULQIZA



Atdhetare Kulturore



GAZETA BULQIZA



KRYEREDAKTOR: HALIL RAMA

Nr.1(70). JANAR 2026

AKTUALITET



**KRYEBASHKIAKJA
MJESHTRI,
MESAZHE
PAQEJE**

Faqe 3

PERSONAZH



**DR. ARDITA KOÇI
SJELL RISI NË SHËR-
BIMIN E PERIODON-
TOLOGJISË**

Faqe 8- 9

IN MEMORIAM



**TRASHËGIMIA STUDI-
MORE-SHKENCORE DHE
PUBLICISTIKE E PROMO-
VUESE E FATOS DACIT**

HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

Faqe 4

ANALIZA/Ecuria e punës në veprimtarinë minerare të zonës së Bulqizës gjatë vitit 2024-2025

DISA PROBLEMATIKA ME TË CILAT PËRBALLET VEPRIMTARIA MINERARE

100 – VJETORI I LINDJES Faqe 5

**Rrahman Hanku,
njeriu që modeloi
infrastrukturën e
Shqipërisë**

HISTORIA Faqe 3

Rivitalizimi i objekteve me vlerë
të trashëgimisë kulturore

**RIJETËZIMI I
KULLAVE**

POEZI Faqe 14

Kushtuar Hafiz Sherif Langut,
delegatit të pavarësisë, të cilit ju
mohua kontributi atdhetar për
50 vjet me radhë

**RREZATO
O NDERI I KOMBIT**

NGA SAKIP CAMI


**“KLITHMA E
ZEMRËS” DHE
“UDHËTIM NË KUJTESË”**

NGA BARIE ÇUPI

PROMOVIMI Faqe 14

• “FSHATIYNË LUBALESHI”,
VEBI MUSTA, LIBËR
KUSHTUAR VENDLINDJES

• SKËNDER MURRJA
PROMOVON LIBRIN “PO
KTHEHEM NË HOTESH”



Ing. Bukurosh KOÇI:

- Operatorët minerarë shprehin gatishmërinë për të investuar në kërkim-zbulim, por kjo kërkon stabilitet ligjor, procedura të qarta dhe mbështetje institucionale, pasi në të kundërt rrezikohet ndërprerja graduale e aktivitetit në disa miniera, me pasoja të drejt-përdrejta ekonomike dhe sociale për zonën

Faqe 2

TAKIM POETIK

Faqe 15

SHOQATA ATDHETARE KULTURORE “BULQIZA” PROMOVON LIBRAT ME POEZI “FRYMOJ ME TY VENDLINDJE” DHE “NGJYRAT E SHPIRTIT”.

**ARTI LETRAR BASHKON BREZAT NË
FAMILJEN “ALLIU” TË BULQIZËS**



NGA BASHKIM LAMI

65 – VJETORI I LINDJES

Faqe 10-11

MUJO BUÇPAPAJ: “HALIL RAMA, KRIJUESI QË NGRITI
FJALËN NË KULT TË MEMORIES KOMBËTARE

**ODA DIBRANE SI
INSTITUCION
VLERASH NË POEZINË E
HALIL RAMËS**

Nga Nexhbedin Basha

SPECIALE

Faqe 6-7

**TREGIME TË VJETRA
POPULLORE PËR
SKËNDERBEUN DHE
RËNDËSIA E TYRE**

Nga Adriatik BALLA

DOSSIER

Faqe 15

**VALLJA E GRAVE
TË BULQIZËS DUHET
DËRGUAR NË UNESCO**

DHURATA KOLA KALOSHI

DOSSIER

Faqe 15

**SHKOLLA E VIÇISHTIT,
28 DHJETOR 1944**

NGA KUJTIMET E SKËNDER MENZELXHIUT

DISA PROBLEMATIKA ME TË CILAT PËRBALLET VEPRIMTARIA MINERARE



ING. BUKUROSH KOÇI

Së pari, i urojmë gëzuar Vitin e Ri 2026 të gjithë punonjësve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineralit të kromit, veçanërisht atyre të fabrikave të pasurimit të kromit në Bulqizë, Kalimash, Gjakovë, punonjësve në minierat e kësaj shoqërie në Qafë-Lamë, Klos, Tërnovë Bulqizë, Kalimash Kukës, si dhe gjithë punonjësve të industrisë minerare në Shqipëri. Gjatë vitit 2024-2025 sektori minerar në zonën minerare Bulqizë-Klos ka punuar në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të kromit duke prodhuar mineral kromi të pasur me cilësi 32-42% Cr2O3 për eksport si dhe mineral të varfër për furnizimin me lëndë të parë të disa fabrikave të pasurimit të kromit në Bulqizë, Batër, Krastë, Tërnovë, Kalimash etj.

Sektori minerar në Bashkinë e Bulqizës dhe Klosit është sektori kryesor për zhvillimin ekonomik si dhe punësimin e zonës. Lejet minerare në këto zona sipas bashkive janë: në Bulqizë 114 dhe në Klos 22.

Sipas statistikave zona me më shumë leje minerare në Shqipëri është zona mineral-mbajtëse Bulqizë-Martanesh. Vetëm në Bashkinë e Bulqizës janë ndërtuar 8 fabrika për pasurimin e kromeve të varfëra.

Në veprimtarinë minerare (Zona e Bulqizës), sot janë të punësuar rreth 4000 punonjës të profesionëve: inxhinierë miniere, pasurues, gjeologë, makshedër, ekonomiste, minatorë, zjarmëtarë, punëtorë, teknologë, manovratorë, teknikë elektrikë etj.

Prodhimi i mineralit të kromit të pasur dhe të varfër për vitin 2025 parashikohet të kapë shifrën e rreth 450 000 ton mineral kromi i varfër dhe i pasur.

Prodhimi i koncentratit të kromit gjatë vitit 2025 arriti rreth 50 000 ton.

Disa nga problemet që kërkojnë zgjidhje janë:

Problemi kryesor ka qenë dhe mbetet mungesa e fuqisë punëtore, si dhe moshë mesatare mbi 50 vjeç e punonjësve në sektorin minerar. Kjo situatë tregon se interesi i të rinjve për të punuar në miniera apo fabrika pasurimi mbetet i ulët, pavarësisht përpjekjeve të subjekteve minerare për të rritur pagat dhe përmirësuar kushtet e punës e të mjedisit. Operatorët minerarë po përballen me vështirësi reale në sigurimin e stafit të kualifikuar, ndërkohë që puna kërkon përgjegjësi të lartë, disiplinë teknike dhe përvojë profesionale.

Në mungesë të politikave mbështetëse për formimin profesional dhe integrimin e të rinjve, barra e vazhdimësisë së

• Operatorët minerarë shprehin gatishmërinë për të investuar në kërkim-zbulim, por kjo kërkon stabilitet ligjor, procedura të qarta dhe mbështetje institucionale, pasi në të kundërt rrezikohet ndërprerja graduale e aktivitetit në disa miniera, me pasoja të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale për zonën



prodhimit mbetet kryesisht mbi punonjësit me eksperiencë, duke rritur kostot dhe kufizuar mundësitë për zgjerim të aktivitetit.

Rezervat minerare në shumë nga objektet ekzistuese janë pakësuar ndjeshëm, duke e bërë të domosdoshëm intensifikimin e punimeve të kërkim-zbulimit për identifikimin e rezervave të reja minerare. Këto punime janë thelbësore për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit prodhues, planifikimin afatgjatë të investimeve dhe ruajtjen e vendeve të punës.

Operatorët minerarë shprehin gatishmërinë për të investuar në kërkim-zbulim, por kjo kërkon stabilitet ligjor, procedura të qarta dhe mbështetje institucionale, pasi në të kundërt rrezikohet ndërprerja graduale e aktivitetit në disa miniera, me pasoja të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale për zonën.

Pothuajse çdo vit, subjektet minerare përballen me rritje të reja taksash apo tarifash, si nga institucionet qendrore ashtu edhe nga ato vendore. Këto ndryshime, shpesh të paparashikueshme, e bëjnë më të vështirë planifikimin e aktivitetit dhe investimeve afatgjata. Për prodhuesit, çdo rritje shtesë e kostove reflektohet drejtpërdrejt në aftësinë për të mbajtur ritmin e prodhimit, për të investuar në teknologji dhe për të garantuar stabilitetin e vendeve të punës, sidomos në një sektor që tashmë përballen me sfida të shumta.

Ka ardhur koha që një subjekt kur të pajiset me leje minerare të jetë i kompletuar me të gjitha lejet e duhura, si: leje e lëndëve plasëse, si dhe zona ku do punohet të jetë hequr nga fondi pyjor, pasi çdo subjekt paguan taksën e rehabilitimit për çdo leje minerare gjatë të gjithë kohës së shfrytëzimit.

Problem tjetër gjatë vitit 2025 ka qenë rënia e kërkesës në treg, rënia e theksuar e çmimit të mineralit dhe koncentratit, si dhe rënia e kursit të dollarit me rreth 20%, në krahasim me vitin paraardhës.

Veprimtaria minerare në Bulqizë, Klos, Kukës dhe Tropojë nuk është vetëm një aktivitet ekonomik, por edhe një faktor i rëndësishëm social. Mijëra familje varen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga puna në miniera dhe fabri-



ka pasurimi. Çdo luhatie në prodhim, çmime apo kërkesë në tregun ndërkombëtar reflektohet menjëherë në të ardhurat e familjeve, në bizneset lokale dhe në nivelin e jetesës së komunitetit.

Lidhur me eksportin e mineralit të kromit, përveç këtyre shkaqeve, ka patur edhe raste mospërputhjeje të cilësisë së mineralit nga nisja në Durrës, në mbërritje në Kinë. Kjo ka sjellë që disa blerës seriozë kinezë, të largohen nga Shqipëria duke shkuar në vende të tjera si Zimbabve për blerjen e mineralit të kromit. Kjo kërkon një ndërhyrje dhe kontroll nga institucionet, si: dogana, AKBN etj.

Lidhur me rentën minerare, në kushtet aktuale të tregut, mendojmë që, edhe renta mineare që sot është 9% e vlerës të shitur të mineralit në eksport, duhet të ulet në varësi të çmimit të tregut dhe cilësisë së mineralit, duke iu referuar vlerës së kostos së nxjerrjes së 1 ton mineral në dalje të galerisë dhe jo të paguhet rentë minerare edhe për vlerën e transportit nga Bulqiza apo miniera në Durrës, si dhe vlerës së shërbimeve portuale.

Ka ardhur koha që për shkak të kostove të larta të nxjerrjes së mineralit të kromit të varfër renta minerare për minerale kromi me përmbajtje të Cr2O3 nën 20% të jetë 0, si në rastin kur shkon në përpunim të brendshëm, ashtu edhe për eksport.

Theksojmë që kostot e nxjerrjes së një ton mialral kromi i varfër apo i pasur janë të njejta por çmimet ndryshojnë me shifra 20-30 herë më të larta se kromi i varfër për kromin e pasur. Kjo do të bënte një riaktivizim ose futje në punë të të gjithë minierave që kanë cilësi të ulët të kromit nën 20% Cr2O3.

Aktualisht në mbi 80% të këtyre minierave, apo lejeve minerare nuk punohet për shkak të kostove të larta, si dhe mungesës së tregut. Për shembull, nëse do të eksportojmë mineral kromi të varfër nga Shqipëria në Kosovë me një çmim 10 dollarë/ton me përmbajtje Cr2O3 prej 13%, renta minerare do të jetë 9%, jo e vlerës së mineralit të shitur, por e vlerës sipas vlerësimit të një komisioni AD-HOC, që për rastin konkret do të jetë rreth 36-40 dollarë/ton. Në këtë rast, në vend se të paguhen 0.9 dollarë/ton, paguhen 2.7 dollarë/ton, që kap vlerën 27%.

Ky është shaku që sot bën të pamundur eksportin e kromit të varfër për përpunim të mëtejshëm në Kosovë. Theksojmë që distanca nga minierat e kromit të varfër në zonën e Hasit dhe Tropojës, për në fabrikat e pasurimit në Gjakovë është rreth 20 km.

Një mundësi e madhe për rritjen e prodhimit të mineralit dhe koncentratit të kromit, është edhe riciklimi i mbetjeve minerare, për të cilat mendojmë se duhet hartuar një strategji e veçantë duke saktësuar sasitë, vendndodhjen, cilësitë, si dhe mundësitë e përpunimit apo teknologjitë e pasurimit.



ATMOSFERË FESTIVE NË BULQIZË



Epaimagjinueshme atmosfera në Bulqizë për ndezjen e dritave të pemës së fundvitit. Mes qindra pjesëmarrësve, si një familje e madhe që gëzojnë njësoj në ditë si këto, u shënuar edhe nisjen zyrtare të festimeve të dhjetorit në qytet. Kryetarja e Bashkisë, Znj. Festime Mjeshtri ka falënderuar secilin pjesëmarrës, ata që sollën fëmijët për të parë gjithë

programin artistik të përgatitur me shumë kujdes. “E kam shijuar pa fund çdo moment të këtij aktiviteti, sepse para meje kisha sytë e dhjetëra prej tyre që qeshnin pa fund, gëzonin me gjithë shpirt, këndonin e kërcenin. Ky është vetëm fillimi i një muaji që nuk do të lërë askënd pas, veçanërisht ata që sytë i kanë drejt nesh të rinjtë, të moshuarit, të pamundurit dhe gratë heroína që ky qytet ka”, tha kryebashkiakja Mjeshtri. Ajo ju përcolli me gjithë zemër urimin dhe lutjen e madhe që ky fundvit ta gjejë secilën familje bulqizake mirë me shëndet, e të rrethuar me dashuri, ngrohtësi e lumturi. Më pas kryetarja e Bashkisë falenderoi ekipin e saj për punën e mrekullueshme dhe përkushtimin pa orar, nga përgatitjet deri në realizimin e këtij aktiviteti, që u kthye në një mbrëmje të bukur për qytetin. Po ashtu kryebashkiakja Mjeshtri falenderoi këngëtarët dibranë Vera Laci, Altin Sulku dhe Fatjon Dervishi që, si gjithmonë, nuk u kursyen aspak për të ardhur e për të ndarë momente gëzimi me qytetarët e Bulqiz kryebashkiakja Mjeshtris dhe për ta bërë këtë mbrëmje edhe më të veçantë për të gjithë.

FESTAT, TË KONCEPTUARA SI PARADË E TË RINJVE

Festat e Nëntorit (festa e Flamurit më të bukur në botë) Bashkia Bulqizë i konceptoi si një paradë që do të përfshinte të gjitha shkollat, për të treguar

sesa shumë të rinj ka kjo bashki. “Bëmë shumë mirë, pasi ky ishte një nga aktivitetet më të bukura, më të hareshme dhe më kuptimplotë. Ky aktivitet dhe këta të rinj na kujtojnë se sa shumë përgjegjësi kemi si drejtues, si mësues dhe si prindër, për t’i udhëhequr drejt ëndrrave të tyre, drejt rrugëtimit jetësor, për të qenë mbi të gjitha qytetarë të denjë për Shqipërinë Europiane”, tha kryebashkiakja Mjeshtri për gazeta “Bulqiza”



KRYETARJA E BASHKISË FESTIME MJESHTRI, MESAZHE TË QARTA PËR PAQE

11 përfaqësues dinjitoz të Bulqizës, “Ambasadorë për Paqen”

• **Kryetari i FPU Shqipëri Defrim Methasani falenderoi për zemërsisht kryetaren e Bashkisë Bulqizë, Znj. Festime Mjeshtri, për kontributin e saj të vyer dhe stafin e Bashkisë për angazhimin dhe mbështetjen që i dhanë Këshillit të Paqes Bulqizë me kryetar zotin Flamur Meta dhe nënkryetarin e këshillit rajonal të paqes zotin Korab Kika, në realizimin me sukses të veprimtarisë së datës 4 nëntor 2025**

Bulqiza është shembulli më i mirë sesi brenda një mjedisi të vogël bashkëjeton një komunitet divers, që ka përqafuar kulturat, traditat dhe zakonet e gjithsecilit. Një mjedis ku askush s’ka njohur konflikte për shkak të të qenit ndryshe përkundrazi, kemi ditur të jetojmë në paqe mes nesh.

Ky ishte edhe mesazhi që kryebashkiakja Festime Mjeshtri përcolli në super aktivitetin e organizuar nga Federata e Paqes Universale Shqiperi, e moderuar me shumë profesionalizëm nga Defrim Methasani, njëkohësisht Kryetar i Federatës.

Së bashku me përfaqësues të komuniteteve fe-

tare, u përcollën mesazhe të qarta për paqe, bashkëjetesë, harmoni dhe respekt të ndërsjellë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së vlerave që na bashkojnë.

Zoti Methasani e falenderoi për zemërsisht kryetaren e Bashkisë Festime Mjeshtri, për kontributin e saj të vyer dhe stafin e Bashkisë për angazhimin dhe mbështetjen që i dhanë Këshillit të Paqes Bulqizë me kryetar zotin Flamur Meta dhe nënkryetarin e këshillit rajonal të paqes zotin Korab Kika, në realizimin me sukses të veprimtarisë së datës 4 nëntor 2025. Ajo sallë e mbushur plot, prania e përfaqësuesëve të komuniteteve fetare, ardhja e 7 drejtuesëve dhe përfaqësuesëve më të lartë të FPU dhe vlerësimi me titullin “Ambasador për Paqen” të 11 përfaqësuesëve dinjitoz të komunitetit, treguan vlera reale dhe i dhanë shumë kuptim këtij takimi ku në epiqendër ishte fryma dhe harmonia fetare dhe ndërkrahinore. Si kryetar i FPU Defrim Methasani, këtë falenderim e bëri publikisht dhe i ftoj përbashkëpunim të vazhdueshëm

Projekt që rivitalizon objekte me vlerë të trashëgimisë kulturore

RIJETËZIMI I KULLAVE...



“Na përkëdhelet sedra kur programe të tilla kaq domethënëse si Programi i Rijetëzimit të Kullave që përfshin plot 4 qarqe prezantohen pikërisht këtu, në një nga kullat e Bulqizës.

E kam thënë shpesh që mund të jemi një bashki e vogël, por jo në vlera, jo në traditë, jo në kulturë”, tha kryetarja e Bashkisë, Znj. Festime Mjeshtri gjatë pritjes së ministrit të Turizmit, kulturës dhe Sportit Blendi Gonxhja në mjediset e Kulla HUPI. Në këtë takim merrnin pjesë edhe përfaqësues të GIZ Albania, për të diskutuar vizionin dhe drejtimin e këtij programi. Rijetëzimi i Kullave si bujtina, qendra kulturore dhe vende mikpritjeje do të thotë, ruajtje e historisë sonë dhe promovim i kulturës, e jo vetëm.

Ky është një projekt që rivitalizon objekte me vlerë të trashëgimisë kulturore, të cilat në fshatrat e Bashkisë Bulqizë janë disa. Vetëm para dy muajsh promovuam librin e Vebi Mustës “FSHATI YNË LUB-ALESHI”, ku i kushtohet një kapitull më vetë arkitekturës së kullave dy e tre katëshe të këtij fshati dhe ku kryetarja e Bashkisë, Znj. Mjeshtri foli edhe për rijetëzimin e këtyre resurseve të rralla...

“Si bashki, kemi detyrimin të identifikojmë dhe kuptojmë nevojat që lindin nga këto iniciativa duke lehtësuar me infrastrukturë, me dokumentim, me mbështetje dhe çdo facilitet që varet prej nesh”, tha kryebashkiakja Mjeshtri. Në një linjë me kolegët Valbona Kola, Rahim Spahiu ajo shprehu mirënjohje dhe optimizëm për këtë program, i cili pa dyshim do ti japë hov të ri ekonomisë lokale, duke hapur rrugë për turizëm të qëndrueshëm dhe sipërmarrje rurale.



Trashëgimia studimore-shkencore dhe publicistike e promovuese e Fatos Dacit

HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

Mbi 60 libra të botuar në harkun kohor të tri dekadave, disa prej të cilave vepra studimore-shkencore që hedhin dritë mbi historinë e Dibrës dhe vendlindjen e Shqipërisë, Fatos Daci padyshim ishte dhe mbetet një prej autorëve më produktivë e cilësorë të këtij çerekshekulli.

Ai u nda nga jeta të dielën e 7 dhjetorit 2025, duke lënë në fondin e artë të librit shqip një trashëgimi mjaftë të pasur letrare, publicistike, studimore e shkencore. Krijimtaria e tij rrok një larmi temash, ku dominon historia... Historia, e shkruar me vërtetësi, bazuar në të dhëna arkivore, në një bibliografi tejet të pasur si dhe në dëshmi gojore nga personazhe realë bindës.


Mbi këtë bazë e ka shkruar ai veprën monumentale “DIBRA-HISTORIA E PLOTË”, ashtu siç ka shkruar edhe veprat tjera: “Enciklopedia e Dibrës”, “Penat e Dibrës”, “Nga lashtësia deri në vitin 1940”, “Skënderbeu i vërtetë”, “Të vërtetat për Skënderbeun”, “Kastriotët e Çidhnës së Dibrës”, “Peshkopia”, “Çidhna dhe Kastriotët”, “Sillova përjetatë një shekulli”, “Histori e shkruar me pushkë e penë”, “Vendlindja ime (Dibra e Bulqiza), “Gryka e Vogël”, “Radomira”, “Shqiponjat e kreshtave të Veriut”, “Të pavdekshmit”, “Burrat e Kullës së Canit”, “Kukësi-Enciklopedi”, si dhe disa monografi për patriotë të Dibrës e Kukësit.

Krenar, si rrallëkush për historinë e lavdishme të Dibrës, Fatos Daci shkroi me kurajo e vërtetësi veprën e tij madhore “Fitorja e Kosovës në duart e Dibrës”, bazuar kjo në kontributin e shquar të personaliteteve dibrane që nga epoka e lavdishme skënderbegiane e deri tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dhe po si rrallëkush, Fatos Daci ka dhënë një kontribut të veçantë në pasurimin e letërsisë sonë dokumentare. Këtë e dëshmojnë botimet e tij: “Historia arsimi shqip në Dibrë”, “Historia e mjekësisë dibrane”, “Historia e kulturës dibrane”, “Antologjia e poezisë dibrane” (në dy vëllime) “Dibra 07” – antologji”, “Shqiponja fluturoi nga foleja”, “Një shekull poezi dibrane”, “Histori e shkruar me pushkë e penë”, si dhe “Në Amerikë flakëron atdhetaria dibrane”.

Një ndër gjinitë më të lëvruara, ku spikat stili i tij origjinal është monografia. Janë dhjetra monografi të këtij autori kushtuar figurave të ndritura të Dibrës, luftëtarë e patriotë të mëdhenj, artistë e mësues, ndër të cilat mund të përmendim ato me titull: “Lirë Rasha - identiteti i vlerave”, “Burri i madh i Bulqizës”, “Mehmet Duriçi”, “Krushqit elirisë”, “Mahmut Daci, princi i trimërisë”, “Rahman Doda i Reçit”, “Met Kaca dhe pasardhësit”, “Hysen Bara, pari e Dibrës”, “Pilket e Dibrës”, “Estref Gjoshi...”, “Dodajt e mëdhenj të Dibrës”, “Pasardhës të Dodajve të mëdhenj”, “Njeriu që di të bëjë gjera të mira”, “Miftar Fana, Nderi i Kombit”, “Rahman Rasha” etj. Përveçse pasurimit të mendimit estetik nga vepra në vepër, F.Daci nuk la pas dore edhe promovimin e vlerave më të mira të Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Këtë e ka bërë më



• **Libri më i fundit i Fatos Dacit “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibrë”, me fakte, argumente shkencore, referenca nga autorë vendas e të huaj, është një kontribut i veçantë në historinë skënderbegiane**



së miri në botimet e tij: “Pena e Dibrës”, “Vendi i artistëve”, “Shpërthime rinore”, etj.

Po në këtë këndvështrim duhet parë edhe kontributi i këtij autori në fushën e së drejtës, i reflektuar më së miri në librin e tij “Trajtime juridike”.

Gjatë një studimi për veçoritë e LANÇ në Dibrë, kolegu dhe bashkëautor im në disa botime, Sakip Cami, më tha para disa ditësh se nga shfletimi i arkivës së gazetës “Ushtima e Maleve” të 30 viteve (1970-1990) kishte evidentuar Fatos Dacin si autorin me më shumë artikuj publicistikë, si reportazhe, skica, esse, fejtone.

Veprimtarinë e tij publicistike Fatos Daci, jo vetëm që nuk e ndërpreu në vitet ‘90, por e pasuroi dhe çoi edhe më tej gjatë këtij çerekshekulli, kur nga viti 1998 boton gazetën e pavarur “Dibra”, e cila nga numri i parë e deri më sot (edhe në versionin online) në qendër ka pasur Dibrën, dibranët dhe historinë e lavdishme, të djeshme e të sotme, të tyre. Ndërkohë, si kryeredaktor ka drejtuar edhe gazetën “Zëri i Lirë” dhe “Trojet shqiptare”.

KONTRIBUT REAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE

Libri më i fundit i Fatos Dacit “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibrë”, me fakte, argumente shkencore, referenca nga autorë vendas e të huaj, është një kontribut i veçantë në historinë skën-

derbegiane. Për herë të parë ai sjell në shqip një dokumentar të Institutit të Studimeve Ushtarake të Turqisë (Milli Savunma Üniversitesi-Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare) të Turqisë ku saktë dhe qartë thuhet: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu u lind më 1405, në fshatin Sinë të Dibrës (Kjo shqiptohet qartë në dy fjalitë e para të dokumentarit në fjalë)”.

Duke e publikuar këtë të vërtetë në librin e tij voluminoz me 497 faqe, studiuesi Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, shprehet entuziast për faktin se: “Për herë të parë, Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës! Dhe kur vulos Turqia, ish-superfuqia e kohës, nuk ka më fjalë. Shqip: Skënderbeu ishte dibran. Pra, ishte shqiptar!”

Po në këtë libër (fq.59) studiuesi Daci sjell referenca nga Akademia e Shkencave të RSH, konkretisht nga Sesioni Shkencor rreth origjinës dhe prejardhjes së Kastriotëve mbajtur në Peshkopi më 2 Nëntor 1985 me rastin e 580-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Skënderbeut dhe inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës.

Dhe nëse Prof. Sterfanaq Pollo ka deklaruar në fjalën e tij përmbyllëse të këtij sesiioni shkencor se: “Tani mund të themi se origjina e Kastriotëve është Çidhna, është Sina”, Fatos Daci argumenton, se “Ky dokumentar i tanishëm, i serialit turk ‘Jetë luftëtarësh’,

i dha publikisht të drejtë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të saj të Historisë për ngritjen në Sinë, në nëntor 1985, të Muzeut të vetëm të Kastriotëve”. Autori i librit mjaftë voluminoz “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibrë”, me të drejtë ndjehej mirë me këtë konkluzion të pritshëm të shkencës ushtarake turke, për faktin se me argumentet e tij, për gjatë 20 vjetëve, në katër libra që ka shkruar e botuar për Skënderbeun, në qindra artikuj që ka botuar në organe të ndryshme të shtypit ditor dhe atij periodik, në dhjetëra intervista televizive dhe në dhjetëra veprimtari publike që ka zhvilluar në institucionet publike të Tiranës, në Peshkopi a në Dibrë të Madhe, ka thënë e shkruar, ka këmbëngulur vazhdimisht me zë të lartë se, për një mijë arsye, Skënderbeu është dibran dhe ka lindur në Dibrë, në krahinën e Çidhnës.

KA REALIZUAR DISA DOKUMENTARË TELEVIZIV

Me profesionalizëm dhe talent të rrallë Fatos Daci ka realizuar disa dokumentarë televiziv. Në memorien e bashkëkohësve janë të freskët dokumentarët e realizuar prej tij me titujt: “Origjina e vërtetë e Ataturkut”, “Kuvndet e Dardhës së Dibrës”, “70 vjet shkollë pedagogjike”, “Sillova mes heroizmit dhe ndryshimit”, “Didajt e mëdhenj të Reçit të Dibrës”, “Kalisi përkujton dëshmorët”, “Kalisi në festë”, “Mahmut Daci” etj, (të shfaqura në ekranet e televizioneve kryesore publike shqiptare). Po ashtu ka spikatur në intervistat e emisionet televizive e radiofonike, duke promovuar vlerat atdhetare, patriotike, kulturore, krijuese e historike të Dibrës dhe dibranëve.

Kësisoj, i lindur në Dacallë të Sllovës, Fatos Daci ia kushtoi jetën dijes, shkrimit dhe dokumentimit historik të trojeve shqiptare, duke lënë pas një trashëgimi të pazëvendësueshme.

Në një krijimtari mbi pesëdekadëshe, ai botoi më shumë se 60 vepra historiko-enciklopedike me mbi 15 mijë faqe, duke dokumentuar figura, ngjarje, tradita dhe dëshmi historike të Dibrës dhe mbarë shqiptarisë.

Veprat e tij shoqërohen me mijëra fotografi të rralla, portrete e dokumente, që sot përbëjnë një pasuri të rrallë kombëtare.

Fatos Daci ishte, Anëtar i përhershëm i Akademisë Amerikano-Shqiptare të Shkencave dhe Arteve, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe kryetar i Unionit të shkrimtarëve dhe artistëve dibranë dhe i disa shoqatave kulturore e atdhetare, Fatos Daci mbetet një prej personaliteteve më prodhimtare të letrave shqipe.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm, ai u nderua me tituj të shumtë, mes tyre “Mjeshtër i Madh”, si dhe u shpall disa herë “Qytetar Nderi” nga Bashkia Peshkopi, Komuna Dibrë e Madhe, Maqedoni dhe disa komuna të Dibrës.

Siç shkruan djali i tij Jordani, një prej emrave më të spikatur të drejtësisë shqiptare: “Fatos Daci largohet nga jeta, por jo nga kujtesa jonë, ai lë pas një pasuri të pamatë shpirtërore e dokumentare, që do t'i shërbejë brezave përjetësisht”.

100 vjetori i lindjes

Ishte dhe mbetet legjendë në mendjet dhe zemrat e bashkudhëtarëve të armatës së ndërtuesve....

Rrahman Hanku, njeriu që modeloi infrastrukturën e Shqipërisë

• Në emër të Shoqatës Bashkësia Dibrane, kryetari i kësaj Shoqate Prof. asc. Dr. Saimir Shatku i dorë zoi vajzës së Rrahman Hankut titullin “Fisnikëria e Bashkësisë Dibrane në Tiranë”, me motivacionin: “Në vlerësim të kontributit të Rrahman Hankut si personalitet i spikatur i fushës së ndërtimit dhe përfaqësues i shquar i komunitetit dibran në Tiranë.”

Në Sallën e Konferencave të Tirana International Hote, më 18 Nëntor 2025 u zhvillua një aktivitet përkujtimor me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Rrahman Hankut, një prej personaliteteve më të shquara të ndërtimit në Shqipëri.

Hanku ka qenë drejtuesi kryesor i ndërtimit të pothuajse të gjithë hidrocentraleve dhe shumë veprave të mëdha industriale të vendit nga vitet 1945 deri në mesin e viteve '80.

Në këtë event morën pjesë ish-kuadro të sektorit të ndërtimit, inxhinierë, arkitektë,



kolegë dhe familjarë, të cilët në fjalët e tyre vlerësuan kontributin 40-vjeçar të Hankut

në projektimin dhe drejtimin e veprave hidrike, të industrisë kimike, të hekurudhave dhe të



shumë veprave të tjera madhore që shënuan zhvillimin industrial të Shqipërisë.



Gjatë aktivitetit u shfaq edhe një film dokumentar, i cili pasqyroi jetën dhe veprimtarinë e Rrahman Hankut, që nga rinia dhe pjesëmarrja në Luftën Antifashiste, e deri te drejtimi i ndërtimit të disa prej projekteve më të rëndësishme kombëtare, duke e cilësuar atë si një ndër ministrat më të suksesshëm të ndërtimit në vend. Në emër të Shoqatës Bashkësia Dibrane, kryetari i kësaj Shoqate Prof. asc. Dr. Saimir Shatku i dorë zoi vajzës së Rrahman Hankut titullin “Fisnikëria e Bashkësisë Dibrane në Tiranë”, me motivacionin: “Në vlerësim të kontributit të Rrahman Hankut si personalitet i spikatur i fushës së ndërtimit dhe përfaqësues i shquar i komunitetit dibran në Tiranë.” Rrahman Hanku u përkujtua në 100-vjetorin e lindjes si një nga inxhinierët më të rëndësishëm të veprave energjetike e infrastrukturore të vendit. Inxhinierë e familjarë vlerësuan kontributin e tij nga porti i Durrësit te hidrocentralet, duke e cilësuar “shembull të përkushtimit profesional”. Në aktivitetin që bëri bashkë inxhinierë, studiues e familjarë, u nderua jeta dhe vepra e njeriut që për dekada u konsiderua si specialist inovator në Shqipërinë e gjysmës së shekullit të XX-të.

Rrahman Hanku, drejtuesi që bëri emër në fushën e ndërtimit

ING. ADEM KORMAKU

Në plejadën e ndërtuesve të gjysmëshekullit të kaluar e deri në vitin 2006, kur u nda nga jeta, Rrahman Hanku, inxhinieri dhe për dekada ministër i Ndërtimit, zë një vend të rëndësishëm. Janë me dhjetëra vepra të rëndësishme, objekte kapitale e hidrocentrale e hekurudha që mbajnë idenë, projektimin apo drejtimin direkt nga ana e tij. Pra, një shembull i denjë i gjeneratës së ndërtuesve të gjysmës së shekullit të kaluar, në veprat ku ai punoi e drejtoi, duke lënë njëkohësisht mbresa e kujtime të paharruara tek njerëzit e thjeshtë, tek personeli inxhiniero-teknik dhe administrativ, që punuan me të është Rrahman Hanku, drejtuesi më i suksesshëm dhe njeriu me vizion të gjerë në këtë fushë, njeriu me zemër të madhe...

NJOHJA ME RRAHMANIN

E kam njohur nga afër dhe kam punuar gjatë me këtë njeri. Ai dinte të afronte, të ndihmonte me sa mundësi kishte. Vetëm një fjalë të thoshte Rrahman Hanku, bëhej urdhër e të gjithë i shtroheshin punës për realizimin e vënien në jetë të saj. Nga Rrahman Hanku, kanë përfituar të gjithë drejtuesit e armatës së madhe të ndërtimtarisë. Kontributi i këtij personaliteti filon që nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, në të cilën ai ishte pjesëmarrës deri në çlirimin e plotë të vendit. Madhështia e tij çmohet dhe admirohet. Me mbarimin e luftës, Rrahman i u përkushtua luftës për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta dhe të mbetur në harresë për vite e dekada të shkuara.

NGA NDËRMARRJA E BONIFIKIMIT NË LANABREGAS

Figura e tij, si specialist e si drejtues pikati që në angazhimet e para për rindërtimin e vendit, si teknik në Ndërmarrjen e Bonifikimit të Durrës. Kjo ndërmarrje ishte ngarkuar atëherë për gjithë bonifikimin dhe ndërtimin e urave të Shqipërisë. Po ashtu, kishte në administrim dhe ndërtimin e hidrocentralit të Selitës dhe në hekurudha. Në vitin 1947, Rrahman Hanku u ngarkua me detyrën e përgjegjës të sektorit për rikonstrukcionin dhe rritjen e kapacitetit të ngarkim-shkarkimeve në portin e Durrësit. Me ndërlikimin dhe ngadalësimin e punimeve në hidrocentralin e Selitës, nga mezi i vitit 1948, Rrahman Hanku transferohet këtu në detyrën e drejtorit të kantierit të hidrocentralit me qendër administrative në Lanabregas. Për drejtimin e punimeve që kishin mbetur prapa, që nga vepra e marrjes së ujit tek burimet e Selitës së Madhe (Shëngjergj) e deri në Lanabregas, po ashtu dhe për nënstacionin elektrik të Tiranës, që ende nuk kishin filluar, as dhe ai i Lanabregasit, pa llogaritur linjat e tensionit (të lartë, të ulët e të mesëm) kërkohej një punë e madhe titanike, e cila u besua Rrahman Hankut.

NDËRMARRJA E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE

E ndodhur përballë kësaj situate, qeveria, me vendim të veçantë krijoi Ndërmarrjen e Ndërtimit të Hidrocentraleve (Hidro Elektri), për ndërtimin dhe vënien në... Në ceremoninë e përfundimit të punimeve të këtij tuneli, ishte dhe Enver Hoxha e udhëheqës të tjerë të shtetit të kohës, të cilët u futën e ecën në këmbë nga Lanabregasi e dolën në Qafë Mollë. Tuneli ka një kapacitet të madh rezerve uji, që në rast nevojë, për defekte në tubacionet e Qafë Mollës prapa Dajtit, ai furnizonte Tiranën

me ujë për 48 orë. Inaugurimi i përfundimit të punimeve, vënia në shfrytëzim e hidrocentralit dhe furnizimi me ujë të pijshëm për Tiranën, u bë në 1 nëntor të vitit 1951. Kjo vepër gjigante e asaj kohe qëndron madhështore edhe sot, ndonëse kanë kaluar rreth 65 vite nga vënia në punë e saj. Rrahmani ka drejtuar dhe punimet për ndërtimin e Hidrocentralit të Ulzës.

NË HIDROCENTRALIN E ULZËS

Pra, Ulza, që nga viti 1953 e deri në vitin 1957, nuk ishte vetëm një qendër pune me 4000-4500 punonjës, por edhe një qytezë me rreth 7000 banorë. Një ngjarje e veçantë në kulmin e zhvillimit të punimeve në Hidrocentralin e Ulzës kishte ardhur koha për të filluar montimin e agregateve e makinerive të hidrocentralit. Por doli një problem, ai i kalimit të tyre mbi urë, pasi ato lëvizeshin me mjete shumë të mëdha dhe pesha e tyre ishte shumë e rëndë. Për këtë, u ngrit një komision specialistësh inxhiniero-teknik për të kontrolluar urat ku do të kalonin automjetet me ngarkesën e madhe që do të lëviznin. Komisioni i ktheu përgjigje Rrahmanit se urat nuk kanë garanci për kryerjen e këtij procesi. Ishte kështu një shqetësim shumë serioz. Për këtë, Rrahmani, bashkë me përbërësit e ekipit verifikues, shkuan dhe një herë bashkë për të parë gjendjen në terren. Por thërrasin dhe mjeshtrit e njohur të urave. Rrahmani i drejtohet Kamber Shevrosë: “Si thua ti xha Kamber”? Kamberi mendohet një herë dhe i përgjigjet: “T’i shoh një herë shoku Rrahman”. Kamberi merr një shkallë dhe futet poshtë urës për të parë trarët e saj të drurit një nga një. U binte me sqepar duke dëgjuar tingullin që nxirrte trari i thatë që ndryshonte nga tingulli që jep trari i kalbur. Kur u sigurua që trarët e urës ishin në gjendje të mirë, doli mbi urë si fitimtar dhe i tha: “Shoku Rrahman! Nën përgjegjësinë time të kalojnë makineritë. Ura nuk ka asnjë rrezik!” Rrahman i, ndërkohë, në gjendje gëzimi, u drejtohet inxhinierëve dhe teknikëve të pranishëm dhe u thotë: “Ja, ky është inxhinier i urave dhe mjeshtër i zoti”!

DETYRA TË TJERA TË RËNDËSISHME

Për rezultatet e arritura në rikonstrukcionin e Portit të Durrësit, në Hidrocentralin e Selitës së Madhe, në “Rrugën e Dritës” dhe në vepra e suksese të tjera, Rrahmani emërohet zëvendësministër i Ndërtimit. Por, nuk qëndroi shumë kohë, pasi u rikthye përsëri në Ulzë si drejtor.

Me përfundimin e punimeve dhe vënien në shfrytëzim të Hidrocentralit të Ulzës, Rrahmani transferohet në Fier me detyrën e Drejtorit të Ndërmarrjes së Ndërtimit të TEC-it, Uzinës së Plehrave Kimike, Uzinës Mekanike të Fierit e të tjera objekteve të tjera që do të ndërtoheshin në këtë rreth. Pas përfundimit të këtyre objekteve, emërohet Zëvendësministër dhe më pas Ministër i Ndërtimit. Ai, deri në daljen në pension, e drejtoi këtë institucion të rëndësishëm me profesionalizëm e aftësi të rrallë. Rrahmani, gjithmonë shprehej me mirënjohje ndaj njerëzve të punës, duke i admiruar e falënderuar me shprehjen “...këta të zbardhin fagen”. Gjithmonë ai merrte si shembull Kamber Shevronë, Petro Zorbën, Ilo Venetin, Trajçe Maznikun, Gani Tuçepin, Taqo Mihon, Jonuz Muçën e shumë të tjerë. Shembujt dashamirës, që përmendte ky personalitet dhe qëndrimi ndaj njerëzve të punës, janë të pafundme. Ai ishte dhe mbetet legjendë në mendjet dhe zemrat e bashkudhëtarëve të armatës së ndërtuesve....

Të dhëna dhe analizë për dy toponime të rëndësishme: “Kulla e Skënderbeut” dhe “Gurët e Skënderbeut” në Bulqizë

speciale

Tregime të vjetra popullore për Skënderbeun dhe rëndësia e tyre

Pas çlirimit, shteti i kohës nxori grupe studiuesish në terren për të mbledhur tregimet e moçme dhe rrëfenja që lidheshin me Skënderbeun dhe epokën e tij. Në fakt u mbledh një material i gjerë që ka një rëndësi të madhe në fushën e folklorit por edhe atë historike. Materialet e mbledhura vit pas viti u botuan në artikuj të ndryshëm në veprat historike dhe ato të kulturës popullore, e një pjesë e madhe e tyre u botuan nga Universiteti Shtetëror i Tiranës në vitin 1968, në kuadër të 500-vjetorit të vdekjes së heroit, Skënderbeut.



NGA ADRIATIK BALLA

Nga analiza e tregimeve të mbledhura dalim në konkluzione të rëndësishme, ku:

1. Rajoni që përfshin njësitë administrative të Krujës, Matit dhe Dibrës përbëjnë 2/3 e të gjitha materialeve të mbledhura. Veçanërisht Dibra është bërthama kryesore e rrëfimeve për Skënderbeun, gjë që e dëshmojnë betejat e shumta që ai ka zhvilluar dhe fituar në këtë vend, por edhe se dibranët ishin bërthama më e rëndësishme e ushtrisë së tij.

2. Në rrëfimet popullore një vend të rëndësishëm zë karakteri mitologjik i figurës së heroit, ku ai shihet me fuqi të mbinatyrshme; shpata e tij çante shmëbinj e male, e kali i tij fluturonte nga një shkëmb në tjetrin e nga një mal në tjetrin. Brenda këtij kuadri, me rëndësi janë edhe fuqitë mistike të Skënderbeut, të cilit i zinte vend bekimi apo mallkimi (sikurse mallkon fushën e Vajkalit për të ftohtin e madh, apo disa fise që nuk iu bashkuan luftës së tij, të cilët, për shkak se i nëmi Skënderbeu nuk u shtuan dhe nuk patën dritësi në jetën e tyre).

3. Me rëndësi janë toponimet, që flasin shumë në kuadër të analizës historike. Shpesh toponimet lidhen me jetën dhe veprën e heroit, ndaj sot kemi shumë toponime në rajonin e gjerë të Arbrisë me emra si “gurët e Skënderbeut”, “mali i Skënderbeut”, “gjurma e Skënderbeut” etj.

4. Jo vetëm historia, por edhe disiplina të tjera mund të nxjerrin të dhëna me interes nga tregimet popullore, pasi nxisin fantazinë e studiuesve për të interpretuar fenomene gjeografike si depozitimet lumore, një pyll që ka ekzistuar por sot nuk është më, për burime ujore të humbura etj, apo dhe ndryshime gjeomorfologjike, si psh. që Skënderbeu hodhi gurët të mëdhenj në Vajkal për të bllokuar rrjedhën e zallit në mënyrë që fusha të kthehej në liqen, gjë që do të frenonte otomanët drejt Krujës. Për këtë, gurët që ndodhen në fushë të Vajkalit morën emrin “Gurët e Skënderbeut”.

5. Rrëfimet popullore të vjetra janë ndjenjë e transmetuar brez pas brezi, gojë më gojë, dhe kjo ka mbajtur të bashkuar shqiptarët, pavarësisht ndasive fetare. Mbajtja e Skënderbeut në gojë ishte transmetim i historisë dhe kjo i bën tregimet e moçme me vlera të shumta e unike. Kjo rrugë lidh të shkuarën, me të sotmen dhe të ardhmen.

6. Tregimet për Skënderbeun kanë domethënie të madhe edhe në kulturën popullore, pasi flasin për këngë e valle të trashëguara në shekuj. Këto rrëfime janë shfrytëzuar në çdo kohë nga mjeshtrit për të nxjerrë këngë të tipit epiko-heroike jo vetëm për Heroin, por edhe vetë popullin shqiptar. Domosdo, Dibra dhe zona përreth është gjithashtu një “hambar” i këtyre rrëfimeve, trashëguese e denjë e heroit dhe e famës së tij.

7. Me rëndësi janë rrëfimet edhe në fushën e gjuhësisë, pasi në to gjenden fjalë të vjetra, të ardhura me dialektin original dhe me domethënie të madhe. Në një farë mënyre, në tregimet për Skënderbeun gjuhëtarët mund të gjejnë fjalë të vjetra, por edhe fjalë të reja por në versionin dialektor të kohës. Kjo i jep rëndësi të madhe materialit të mbledhur në popull.

Këtu po ju njohim me disa nga rrëfenjat që lidhen me dy toponime të rëndësishme: Kullën e Skënderbeut, që pozicionohet në malin e Temlës, në krah të Urës së vjetër të Qytetit, pranë fshatit Valikardhë, si dhe rrëfenja që lidhen me Vajkalin dhe betejat e Skënderbeut të zhvilluar aty. Qëllimi është të njohim sa më shumë historinë dhe të nxjerrim mësimë prej rrëfimeve. Materialet po i prezantojmë në versionin origjinal dialektor. Dialekti i përket Peshkopisë, që do të thotë se studiuesi që i ka mbledhur apo qendra që i ka grumbulluar ka qenë në Peshkopë. Për të ruajtur autenticitetin e tregimeve të mbledhura, po i përcjellim në versionin origjinal, sikurse i ka botuar më parë Universiteti Shtetëror i Tiranës, specifikisht Instituti i Folklorit.

A. TREGIME TË MBLEDHURA PËR KULLËN E SKËNDERBEUT

Çfarë është Kulla e Skënderbeut?

Kemi të bëjmë me një fortifikim arbëror të shekullit XV, në kurizin e mprehtë të Temlës që bie thikë mbi fshatrat Peladhi në lindje dhe Fushë-Bulqizë në perëndim, 12km në lindje të qytetit të Bulqizës. Lartësia e kodrinës ku ndodhet kështjella është 978m, afro 400 m lartësi relative nga zalli i Bulqizës. Vendi ku ndodhet kështjella ka një fushëpamje spektakolare, duke qenë kontrolluese e luginës së Bulqizës dhe grykave tërthore që nisin prej saj drejt jugut. Një material të zgjeruar për të ka realizuar profesori i njohur i arkeologjisë, Adem Bunguri.

1. “Skënderbegu ka luftue mjaft, që këtu e n’Tunë. S’ia ka da asnjëherë poteren Turkies. Luftë ka ba Skënderbegu edhe në Fushë të Bulqizës; Fusha e Vajkals i thoshin (më përpara) Fushë-Bulqizës”.
[Mbledhur në Zërqan, Dibër më 6 korrik 1953]
2. “Skënderbegu ka ardhur në Fushë t’Bulqizës. Ate bani luftë me Turkien dhe e ka kthie prapë. Shumë luftë e madhe a ba. A ba vrasje e madhe shumë, i ka dërrmu Skënderbegu me gjurë.”
[Mbledhur në Zërqan, Dibër, më 4 korrik 1953]
3. “Kalanë e Çitetit e ka pas ba Skënderbegu. Ka

ardhë Skënderbegu tue ba luftë, ene ka lanë vend atje, n’Qafë të Kullës. Atje ka ba luftë me Turkien. Merrte ujë Skënderbegu me ushtarët e vet, në zallë. Që kur a rru-ga e mushkave, ka bart ujë në zallë e e çonte te Kulla.”
[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, më 8 korrik 1953]

4. “Skënderbegu e ka pas kullën n’Shkam të Çitetit, në kufi të Bulqizës e Valikardhës. Edhe sot kti veni ku a kulla i thonë te Qafa e Kullës së Skënderbegut.”
[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, më 18.10.1950]

5. “Kulla e Skënderbegut ndodhet në Qafën e Kullës, mi urë të Qytetit. Simas thashave t’pleqet ktu ka ba luftë e turqit Skënderbegu. Kulla ka mure të bbame me gëlqere. Themelet i ka të pashemuna dhe afro dy metër lart. Rrafsha është 5x5m”
[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, më 8.7.1952]


6. “Skënderbeu ka ba kullën në shkam, Kalanë e Çitetit. Kjo ka mure rreth e qark. Muret i ka ma shumë se 1 m të gjana. Asht një rrafshë afër një dinim; ruen Grikën e Çitetit, ka jugu ka një birë që shkojshin ushtarët dhe mirrshin uj pa i pa kush. Kjo kala ka e lemja ka arniet e Valikardhës, ka veriu zallin dhe kepin e Kalasë së Skënderbeut, ka jugu ka ferrishhte qi quhen Nënlivadhe.”
[Mbledhur në Valikardhë, Dibër, më 1953]

7. “Matanë urën ishte çitet, pazar, edhe më kët anë ishte kalaja maje shkamt, kulla.Në Çitet janë gropat e dyqanve ne sojt.”
[Mbledhur në Valikardhë, Dibër, 20 qershor 1953]

8. “Në Çitet ka një kala që i thonë Kala e Skënderbegut. Atje sipër asht Pusi i Skënerit. Ka qanë pus. Në fund të malit ke ura asht një grizë. Si të hish mrena s’un të kalojsh prej laskuriqve. Na kemi pa shtatë rrugica, qemere; pej ati një rrugicë del në kajshën e Valikardhës, njena thonë se del në Librazhd.”
[Mbledhur në Zërqan, Dibër, më 4 korrik 1953]

9. “Atje ka qanë kala, në kohë të përparshme. Ajo kala ka qanë e Skëndervegut. Skanderbeg me nam. Ushtri kishte pak, po zemër kishte shumë, zemrën e madhe. Ai ka qënru me Turkien. E kum nigju fort mirë nga plaku im. Ka pasë kala; bajnë beli shenjat, muret. Ktë kala e ka ba Skënderbegu për herë të parë.”
[Mbledhur në Peladhi, Dibër, më 8 korrik 1953]

10. “N’çitet a ni shpellë qi e ka kryt ke kisha e Valikardhës (ka qanë në kohët e para kishë, sot s’asht ma). Ktu kan pas mçef flori, por kto s’mun ti marri njeri se i rujn gjarpijt e zoqt.”



speciale

Ngajjnë si përralla, por këto janë tregime të mbledhura në popull dhe populli e mbante Skënderbeun në gojë për 500 vjet.



Tregime të vjetra popullore për Skënderbeun dhe rëndësia e tyre

Ngajjnë si përralla, por këto janë tregime të mbledhura në popull dhe populli e mbante Skënderbeun në gojë për 500 vjet. Natyrisht, shumë gjëra janë shtuar e hequr rrugës, por bërthama e rrëfimeve flet për ngjarje të vërteta.

[Mbledhur në Bulqizë, 1953]

B. TREGIME PËR GURËT E SKËNDERBEUT

Në këtë pjesë të dytë, mbi përmbajtjen e materialeve të vjetra arkivore nga ish-Instituti i Folklorit, që u referohen tregimeve dhe gojëdhënave mbi Skënderbeun dhe vendet e tij, sjellim në vëmendje rrëfenjat në lidhje me Gurët e Skënderbeut dhe krijimin e kënetës së Vajkalit në Bulqizë, por njëherësh do të përpiqemi të ndërtojmë një analizë të shkurtër në kuadër të asaj që ne e quajmë “gjeografi historike”.

Çfarë janë gurët e Skënderbeut?

Kemi të bëjmë me një toponim në luginën e Vajkalit, atje ku sot ngrihet monumenti i Skënderbeut, në anën lindore të fshatit Vajkal, vetëm 2.5km në lindje të qytetit të Bulqizës, buzë rrugës nacionale Bulqizë-Peshkopi. Toponimi i referohet një grumbulli gurësh masivë, me volum secili nga 2-3 m3 deri në 10-15 m3, kryesisht në anën e poshtme të xhadesë, por edhe në anën e sipërme. Gurët kanë qenë më të shumtë në të shkuarën, por sot janë të dëmtuar.

Kujtojmë, që vendasit, jetë e mot këtij vendi i kanë thënë “Gurët e Skënderbeut”. Me aq sa di, në asnjë vend fushor në Shqipëri nuk gjen një toponim të tillë, pasi me këtë emërtim jepen toponime në kodra e male por jo në fushë, e kjo e bën atë sa interesant në aspektin studimor, aq dhe kuptimplotë në aspektin e vlerave të trashëgimisë.

Është e qartë se gurët janë të shkëputur nga shpatet e kurrizit që bie pjerrët në luginë të Vajkalit. Ky kurriz, sipas hartës italiane, ka dy kuota për tu shënuar, ajo më pranë gurëve quhet maja e Karakollit, në 1200 m, e pak më në jug maja e Rrasës, ose Rrasa e Duriçeve, në 1536 m. Ky kurriz është një damar i zgjatur drejt veriut i malit të Dhoksit (2020m).

Për rolin natyror por edhe historik të gurëve do të flasim pasi të japim disa gojëdhëna popullore të mbledhura rreth vitit 1950 në fshatrat e zonës.

1. “Fushë-Bulqizës i kanë pas thanë Fushë e Teviolit, sot e përdorin Fush’ e Tezallit. E kom nigju nga një farë Isuf Koçi; ka vdekë 90 vjeç, 20 vjet para. Ai kështu ma ka thane; se un, kur ikëm pi serbit, nejtëm nja di javë në Bulqizë. Pi çati plaku qi t’thash e kom nigju këtë fjalë.”

[Mbledhur në Zërqan, më 4 korrik 1953]

2. “Fusha e Vajkalit ka qanë pyll, po nuk punonin zoqt në të e jo më ropt; ka qenë krejt pishë. Ka pas

vetëm ni uj në mes, Uji me Shtrema i thoshin. Edhe sojt me shtrema është ai uj.”

[Mbledhur në Dushaj (Bulqizë), Dibër, më 1953]

3. “Ku i thonë sot Fusha e Vajkalit, te Gurët e Skënderbegut, ke ka pas ba luftë Skënderbeu, ma parë i thoshin Fusha e Teviolit. E kam nie nga pleqtë e Vajkalit.”

[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, më 8 korrik 1953]

4. “Në Vajkal s’ka pas katund. Kan qanë mashnore. Kur vijn vajkalorët në Koçaj thonë: ‘Shkojmë në katund’. Na të Koçajve dhe të Dushajve u themi mashnorë atyre. Në Vajkal ka qanë bjeshkë, për të kullotur bagtinë në verë. Vetëm ujë të ftoftë, pishë e bar për dele ka pasë. Diqin vjet ma parë në Fushë të Vajkalit ka qanë pishë, s’ka pasë ujë.”

[Mbledhur në Koçaj (Bulqizë), Dibër, më 1953]

5. “Te Gurët e Skënderbegut në Bulqizë, Skënderbegu ishte rretheku. Qi ta nalonte ushtrinë turke, i lshoi si mallkim atij veni që të bante ftohtë. Ene me të vërtetë, po ta kërkosh Shqipninë rreth e qark, ni ven ma t’ftohtë s’ka. Ki ven ban vorre për çdo vjet; ate shkon e s’vjen. Kanë vdekë di vetë prej të ftohtit, lumjanë. Për çdo vjet vdesin.”

[Mbledhur në Dushaj (Bulqizë), Dibër, 1953]

6. “Te Gurët e Skënderbegut në Bulqizë, i kanë mërddhihë zagaret Skënderbegut dhe i kanë cofë prej të ftoftit. Pranej Skënderbegu e ka nemtë atë ven -‘Këtu mos iu ndaftë fortuna, gazeplleku’. Ene n’verë fren ate, jo ma n’dimën qi t’shkul.”

[Zërqan, Dibër, 1953]

7. “Thonë se Skanderbegu ka qanë në majë të Duriçit (mali i Dhoksit) tu gjujtë. Kur ka ra në Fushë t’Vajkalit i kanë mërddhitë langojt. Atëherë Skanderbegu i nemti: - Fryftë e mos zantë karar as dimër, as verë ky vend’. Ene sot ktu fryn e ban ftoftë dimën e verë (prej nams Skanderbegut)”.

[Mbledhur në Bulqizë më 18 tetor 1950]

8. “Kur kishte adhë Skënderbegu një herë në Bulqizë, kishte dalë me gjujt aty afër katunit. Langojt e vet, qi kishin hikë përpara, i gjet tu u zanë me ni kulçedër. Ngre këta gurë të mdhej Skënderbegu, ja fugj kulçedrës dhe e le top në vent. Gurët gjinden te Rrasa e Doriçet dhe quhen Gurët e Skënderbeut.”

[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, 1950]

9. “Ushtria turke po vinte ka Dibra. Skënderbegu i priti te Fusha e Davollit në Vajkal të Bulqizës. Ate nisi të shemë shkamijt e malit e i dërrmoi turqit. Shkaminjt janë edhe sot në Fushë të Vajkalit, pranë

mëhallës së Duriçeve. Populli u thotë Gurët e Skënderbeut.”

[Mbledhur në Vajkal më 18 tetor 1950]

10. “Skënderbeu ka shembë ca gurë të mëdhenj, shkrepë. i shembi se luftoi me Turqinë atëherë, bëri luftë të madhe në Bulqizë. Kur ka lëshuar ata gurët e mëdhenj teposhtë, copëtoi shumë asqerë dhe Turqia u kthye prapa.”

[Mbledhur në Zërqan, Dibër, 4 korrik 1953]

11. “Si e pa që s’e mbajti dot Turqinë, se kishte shumë ushtri me vete, Skënderbeu deshi t’i këpuste rrugën, t’ia zërë. Për këtë lëshoi gurët nga mali që t’i vriste asqerët.”

[Mbledhur në Dushaj (Bulqizë), Dibër, 1953]

12. “Gurët e Skënderbeut janë afër xhades së automobilit, në mëhallën e Duriçeve. Këto i ka shembur Skënderbeu nga mali se deshi të zërë grykën e fushës së Vajkalit, e deshi ta kthejë gjol (liqen) tërë vendin e kësaj fushe. Skënderbeu tha: Do ta bëj këtë vend det.”

[Mbledhur në Vajkal (Bulqizë), Dibër, më 18 tetor 1950]

13. “Skënderbeun e kishte qitë lufta në Lug të Dedes. Kur po shkonte anej, iu sekelldis kali edhe i huti kamba në rrasë. Sot këtij vendi i thonë gjurma e kalit të Skënderbeut.”

[Mbledhur në Vajkal (Bulqizë), Dibër, 1953]

14. “Kali i Skënderbegut, si i vdiq i zoti, erdh kha n’Vajkaltë Bulqizës, vajtoi sa vajtoi ene cofi.”

[Mbledhur në Bulqizë, Dibër, 1961]

15. “Vajkalit të Bulqizës i ka metë ky emën se atej ka ba vaj kali i Skënderbegut, kur vdiq i zoti.”

[Mbledhur në Vajkal, Dibër, 1954]

* * *

Këto janë disa prej tregimeve popullore për këtë toponim, të mbledhura e pasqyruara nga Instituti i Folklorit dhe Universiteti Shtetëror i Tiranës mes viteve 1950-1967. Si gjeograf, po ndalem vetëm te pika 12, ku rrëfenja thotë se gurët u shembën për të zënë grykën e Vajkalit, pra të bllokohej rrjedha e zallit, në mënyrë që fusha e vajkalit të shndërrohej në liqen, kjo do t’ua pamundësonte turqve avancimin drejt Krujës. Ajo që dimë, është se lugina e Vajkalit ka tipare grabenore dhe për tektonikën bllokore vlen shprehja “ngritjet e mëdha shoqërohen me zhytje të mëdha”. Për historinë e krijimit të kënetës në fakt duhet të flasim gjeologët dhe shkencëtarët e tjerë (biologë, gjeomorfologë etj). Janë depozitimet e shumta fluvioglaciare që depozitohen në atë grykë, qoftë nga prurjet e përroit të Duriçeve nga Dhoksi, e qoftë nga përroi i Llapushave nga Balgjai, që kanë sjellë ngritjen e teritorit në atë sektor, duke u bërë kështu pengesë për rrjedhjen e zallit, pra krijimin e kënetës. Gojëdhëna thotë se ishte Skënderbeu që e nxiti këtë, duke shembur gurë të mëdhenj e duke i bërë pritë, për ta shndërruar atë vend në gjol (liqen). Gjithsesi, për këtë çështje kërkohen interpretime shkencore të mirëfillta, ku krahas amplitudes së uljeve tektonike dhe prurjeve të përenjve të mësipërm, duhet pare edhe roli i shfrytëzimit të kromit dhe elementë të tjerë që lidhen si me veprimtarinë shoqërore, aq dhe me ndërhyrjet e pastudiuara në sistemin e kanaleve kul-lues të fushës.

Tiranë, nëntor 2025



Karriera e suksesshme e vajzës nga Bulqiza – Lektore dhe Përgjegjëse Katedre në Western Balkan University, pasi ka kryer studimet universitare dhe doktoraturën në Ankara.

personazh

Dr. Ardita Koçi sjell risi në shërbimin e Periodontologjisë

NGA HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

Ediplomuar para 16 vitesh në Universitetin e Ankarasë, dega stomatologji dhe doktoruar po në këtë universitet në departamentin e Periodontologjisë, Instituti i Shkencave Mjekësore i këtij universiteti, me tezën “Vlerësimi i Ndërveprimit të Hipoksisë dhe Rugës së Kynureninës në Inflamacionin Periodontal”, Dr. Ardita Koçi i është përkushtuar maksimalisht përsosjes së këtij shërbimi që në Shqipëri është i mangët.

Përvojën e pasur të fituar gjatë punës në Klinikën Stomatologjike Universitare të Univesitetit të Ankarasë ku ka patur intensitet pacientësh me shumëllojshmëri sëmundjesh, dhe ku ka patur fatin të shikojë, trajtojë dhe të mësojë nga profesorët më me emër të Ankarasë, ajo po e implementon suksesshëm, tashmë në klinikën e saj “Perio Dental Clinic”, fare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Tiranë.

Në këtë interviste ekskluzive për “Gazetadestinations.al” ajo pohon se ka zgjedhur që drejtimin e praktikës klinike ta ketë të përqëndruar tek ky profil, i cili në Shqipëri është i mangët dhe nuk ka një përhapje të gjerë si një shërbim themelor, që është më se i nevojshëm për t’jua ofruar pacientëve.

Dhe ndërsa evidenton si problematikë kthimin e këtij profesioni që merret imtësisht me shëndetin oral dhe ndërveprimin që ai ka me shëndetin sistematik, në një formë biznesi të pakontrolluar, përgjigjen e ka më se të saktë: “Stomatologjia nuk duhet të orientohet nga logjika e biznesit, por nga përgjegjësia humane dhe misioni për të përmirësuar shëndetin, vetëbesimin dhe cilësinë e jetës së pacientëve tanë. Standardi i punës sonë duhet të mbështetet te etika, kompetenca dhe cilësia, jo te konkurrenca joreale në kurriz të shëndetit të njerëzve”.

Dhe ndër arsytet pse ka zgjedhur të jetë pjesë e universitetit prestigjioz Western Balkans (WBU) ka të bëjë me faktin se një ndër kriteret parimore të tij është ruajtja dhe stimulimi i meritokracisë. Ndaj, inkurajimi i studentëve ekselentë por jo vetëm, për t’i ndihmuar ata të zhvillohen më tej, pse jo dhe jashtë Shqipërisë është pjesë e punës së saj të përditshme.

E njohur ndërkombëtarisht për artikujt shkencorë që ka publikuar, për studime rastesh dhe prezantime sipas dokumentit origjinal, pjesëmarrje në kongrese dhe konferenca ndërkombëtare (2007–2023) Dr. Ardita Koçi është e angazhuar që këtë përvojë dhe karrierë akademike ta implementojë në WBU, ku sipas saj ka studentë shumë të mirë, gjithmonë kërkues, ambicioz dhe është e sigurtë se çfarëdolloj zgjedhje do bëjnë ata në rrugëtimin e tyre, do të jenë shumë të suksesshëm dhe vlerë e shtuar për Shqipërinë.

Në këtë intervistë ajo shprehet edhe për vendimin për tu kthyer në Shqipëri që nuk ka qenë as-



pak i lehtë, por e ndërmori këtë rrugëtim në kërkim të rrënjëve të identitetit të saj, për të lidhur dhe fëmijët me rrënjët e tyre, pavarësisht se asnjëri prej tyre nuk ka lindur në Shqipëri.

Kjo ka të bëjë dhe me karakterin, si përngjasim me babain e saj Isuf Koçin e Bulqizës, një emër i spikatur i elitës dibrane që bëri aq shumë për vendlindjen, duke mbetur simbol i mençurisë, urtësisë dhe mirësisë njerëzore për bashkëkohësit, familjarët, miqtë e shokët e tij të shumtë. Ndërkohë ajo, fare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës ka ngritur klinikën me emrin “Perio Dental Clinic”, ndër më modernet në Shqipëri, për të cilën jep hollësira në intervistën e mëposhtme.

-DR. ARDITA, CILAT JANË RISITË QË OFRON KLINIKA JUAJ?

Nisur nga specializimi im, i cili është Periodontologjia ndryshe, fusha e stomatologjisë e cila merret me sëmundjet e mishrave të dhëmbëve dhe trajtimi i tyre, kam vendosur dhe emrin e klinikës “Perio Dental Clinic”.

Periodontologjia është një degë e stomatologjisë që merret me shëndetin e indeve mbështetëse të dhëmbëve. E thënë më qartë, ne si periodontologje merremi me mirëmbajtjen e një themeli të fortë të dhëmbëve.

Janë pikërisht disa shqetësime, si gjakosja e mishrave të dhëmbëve gjatë larjes apo vetvetiut, era e keqe e gojës, lëvizshmëria e dhëmbëve që me kalimin e kohës fillojnë të bien, disa nga simptomat kryesore që shpesh neglizhohen nga pacientët apo akoma dhe nga dentistët. Ka raste të shumta ku mjeket stomatolog e përmbledhin shkurt duke thene se është me origjinë gjenetike dhe nuk ka trajtim dhe ajo cka ndodh është një humbje kohe duke e bere rastin me te veshitre per trajtim.

Sëmundjet periodontale lidhen me disa gjendje sistematike, përfshirë sëmundjet kardiovaskulare, diabetin, komplikacionet e shtatzënisë, sëmundjet respiratore, artritin rheumatoid dhe gjithnjë e më shumë po vërtetohet lidhja me sëmundjet neurodegenerative si Alzheimeri, ku inflamacioni kronik nga periodontiti mund të kontribuojë në përkeqësimin e proceseve degjenerative në tru.

Unë, pikërisht kam zgjedhur që drejtimin e praktikës time klinike ta kem të përqëndruar tek ky profil, i cili në Shqipëri është i mangët dhe nuk ka një përhapje të gjerë si një shërbim themelor, që për mua është më se i nevojshëm për t’jua ofruar pacientëve tanë.

Pjesë e specialitetit tim janë dhe kirurgjitë e

avancuara, gjithashtu dhe të indeve të buta. Këto kirurgji na ndihmojnë të rikthejmë strukturat mbështetëse të dhëmbëve, përmirësimin e estetikës dentare dhe mbështetjen e trajtimeve me implantet dentare. Implantet dentare i praktikoj që në vitin 2010, kohë e cila përkon me fillimin e trajtimeve më të avancuara që kryenim gjatë periudhës së specializimit.

Gjatë punës në Klinikën Stomatologjike Universitare të Univesitetit të Ankarasë ku ka patur intensitet pacientësh me shumëllojshmëri sëmundjesh, kam patur fatin të shikoj, trajtoj dhe të mësoj nga profesorët më me emër të Ankarasë, të cilët kishin një lidhje të ngushtë me Ballkanin, duke qenë dhe kryetare te Shoqatës Stomatologjike Ballkanike (BASS).

Përpos pjesës së trajtimeve të lidhura me specializimin tim në klinikë ofrojmë dhe terapitë më të fundit bashkëkohore të drejtimin të dhëmbëve nëpërmjet aparateve të tejkdueshme me anë të firmës amerikane numër një (1) në botë, Invisalign.

Gjithashtu merremi me çdo terapi të përgjithshme dentare, e nevojshme për të paraprirë sëmundjet dentare deri tek trajtimi i tyre.

Në kliniken tonë kemi mundësinë që çdo trajtim për të cilin mund të ketë nevojë një pacient ta kryejmë brenda ambienteve tona, duke patur dhe avantazhin e vendodhjes së Laboratorit Dentar fare pranë.

-PSE VENDOSËT TA TRANSFERONI SHËRBI- MIN NGA TURQIA PËR NË SHQIPËRI?

Vendimi për tu kthyer në Shqipëri nuk ishte aspak i lehtë dhe për më tepër nuk përmban vetëm elementin shërbim.

Jam larguar drejt Ankarasë në vitin 2003, drejt një të panjohure që rezultoi shumë më vështirë nga çfarë mund të ishte menduar. Ditët e para kam pa-



tur mbështetje të madhe nga disa prej studentëve shqiptarë që gjendeshin prej kohësh në Ankara dhe për fatin tim të mirë kam patur dy kushurinjtë që studionin mjekësinë atje, Dr. Ajet Xhafa dhe Dr. Ledjana Klllogjeri. Mbështetja e tyre në ambientimin tim atje ka qenë vendimtare.

Më pas studimet dhe vështirësia e të qenurit në një nga universitetet shtetëror më rigoroz të Turqisë më bënë më të fortë. Si studentë kishim mundësinë e të praktikuarit me një numër të madh pacientësh, gjë që të përgatiste shumë mirë për jetën e jashtme si stomatolog. Pas diplomimit përzgjedh në të njëjtin Universitet specializimin për Periodontologji me mbështetjen e plotë të profesorëve të mi.

Gjatë kësaj periudhe unë njihem dhe me tim shoq, Klajdi Koçi, i cili si dhe une ishte student në Universitetin e Hacettepese, në fakultetin e administrimit biznesit. Im shoq ka qenë dhe është fati im i mirë. Mbështetja e vazhdueshme për njëri – tjetrin,

(Vijon në faqen 9)



personazh

Ndër arsytet që zgjedha të jemë pjesë e WBU ka të bëjë me faktin se një ndër kriteret parimore të tij është ruajtja dhe stimulimi i meritokracisë.



(Vijon nga faqja 8)

për të ecur përpara në një vend ku nuk ekzistojnë lidhjet (pasi ishim të huaj), por vetëm meritokracia dhe aftësitë e tua si profesionistë e ka bërë lidhjen tonë më të fortë.

Nënshtetësinë turke e kam marrë në vitin 2017, kohë në të cilën trazirat politike në Turqi ishin në kulm dhe ky moment është i rëndësishëm në një-farë mënyre, sepse nuk ishe më i huaj. Është një moment shumë për të qeshur në fakt, por tek unë ka lënë shenjë.

Një ditë në klinikë pata një pacient të moshuar rreth 75 vjeç dhe pasi bëmë trajtimin më pyet, nga je?

– Jam nga Shqipëria, i thashë.

Përgjigja ishte – Olsun, që do të thotë s’ka gjë.

Një element që njeriu kërkon kur është rreth të 40-ve është ai identiteti, ndjenja e përkatësisë. Pikërisht kjo fjalë “s’ka gjë që nuk je nga këtej” tek unë la gjurmë të thella. Më pas ndodhi pandemia ku të tërë u mbledhëm nëpër familjet bërthamë tonën dhe kështu filluan gjykimet në lidhje me ndryshimin e vendit ku jetonim. Tashmë kërkonim familjen, qoftë timen, qoftë të tim shoqi. Kërkonim më shumë njerëz për të kaluar jetën tonë, por gjithashtu për të lidhur dhe fëmijët me rrënjët e tyre, pavarësisht se asnjëri prej tyre nuk ka lindur në Shqipëri.

Një moment shumë mbresëlënës ishte kërshëria e vajzës time kur pasi u kthyem tha: “Unë nuk e dija që kisha kaq shumë kushurinj”.

Në këtë pikë mund të them që vendimi i kthimit, më shumë se transferim shërbimi ishte ndryshim i vendit ku ne donim të jetonim. Pa anashkaluar dhe faktin që risku i hapjes së një biznesi të ri është shqetësues, aq më tepër në një vend ku nuk ke një historik pacientësh, ambicien për ta bërë të suksesshëm këtë rrugëtim së bashku me motrën Redjonën e kam patur shumë të lartë.

– NË OPTIKËN TUAJ, CILAT JANË PROBLEMATIKAT ME TË CILAT PËRBALLET SHËRBIMI DENTAR NË SHQIPËRI?

Në optikën time, shërbimi dentar në Shqipëri ka bërë një progres të dukshëm vitet e fundit, sidomos falë turizmit dentar, i cili ka sjellë zhvillim ekonomik dhe e ka rritur shumë interesin e të rinjve për profesionin e stomatologjisë. Megjithatë, përballë këtij zhvillimi qëndrojnë disa problematika serioze.

Ajo që më shqetëson më shumë është prirja për ta shndërruar stomatologjinë – një profesion që merret ngushtësisht me shëndetin oral dhe ndikimin e tij të drejtpërdrejtë në shëndetin sistematik – në një biznes të pakontrolluar. Kemi një rritje të ofrimit të shërbimeve dentare me çmime tejet të ulëta, të cilat u paraqiten pacientëve sikur ofrojnë të njëjtin nivel eksperience, cilësie dhe garancie afatgjatë si puna e specialistëve të mirëtrajnuar.

Ky fenomen rrezikon standardet profesionale dhe cenon besimin e pacientëve. Stomatologjia nuk duhet të orientohej nga logjika e biznesit, por nga përgjegjësia humane dhe misioni për të përmirësuar shëndetin, vetëbesimin dhe cilësinë e jetës së pacientëve tanë. Standardi i punës sonë duhet të mbështetet te etika, kompetenca dhe cilësia, jo te konkurrenca jo-reale në kurriz të shëndetit të njerëzve.

–SI PEDAGOGJE NË UNIVERSITETIN WESTERN BALKANS, SI I GJYKONI PRITSHMËRITË

• “Edhe pse e larguar herët jam e lidhur me Bulqizën, sepse përveç rrënjëve atje kam dhe fëmijërinë, kohë e cila lidhet ngushtë me babain tim Isuf Koçin... Si fëmijë nuk mund ti perceptoja sfidat që im atë ka kaluar në jetë, por mund të them që sfidat e mia kanë kaluar suksesshëm për çka unë mbaj në gen dhe për shembullin e fortë që më ka dhuruar babai. Familjarët më thonë që në karakter përngjasojmë shumë dhe jam shumë krenare për këtë. Ndërkohë është i pashmangshëm dhe mendimi që sa i lumtur do të ishte babi në lidhje me kthimin tim, në lidhje me hapjen e një biznesi dhe për më tepër bashkëpunimin e mirë që kemi me motrën, Dr. Redjonën”

E STUDENTËVE PËR LËNDËN TUAJ?

Kur kam pranuar në fillim kërkesën e Universitetit Western Balkans për të qenë pjesë e stafit akademik dhe më pas e emëruar Përgjegjese departamenti, për të ofruar eksperiencën time të marrë nga studimet dhe puna ime disa vjeçare në Turqi, një ndër motivet kryesore ka qenë të isha për këta



student, jo vetëm një pedagoge por dhe një mentore për t’ju qëndruar pranë në çdo kërkesë dhe vështirësi që mund të hasnin gjatë viteve.

Vitet e fakultetit janë sa të vështira aq dhe delikate. Studentët kanë nevojë për një inkurajim të vazhdueshëm, motivim dhe drejtim drejt asaj çfarë ata dinë të bëjnë më mirë, duke i ndihmuar të kuptojnë më mirë veten e tyre dhe aftësitë që zotërojnë.

Duke qenë çdo ditë në kontakt të drejtpërdrejtë me studentët e universitetit WBU kam kuptuar se po jetojnë në një epokë sa të kollajtë aq dhe më të vështirë për ta. Janë një brez i hapur totalisht drejt informacionit të gatshëm, falë zhvillimit dhe aksesit të teknologjisë. Por kjo, nga ana tjetër e bën akoma më të rëndësishëm rolin tonë si akademikë në orientimin e tyre drejt përzgjedhjes së këtij informacioni të pamasë, ndarjen e informacionit të saktë ndaj atij jo të saktë.

Ndër arsytet që zgjedha të jemë pjesë e WBU ka të bëjë me faktin se një ndër kriteret parimore të tij është ruajtja dhe stimulimi i meritokracisë. Inkurajimi i studentëve ekselentë por jo vetëm, për t’i ndihmuar ata të zhvillohen më tej, pse jo dhe jashtë Shqipërisë është pjesë e punës time të përditshme.

Edhe pse Universiteti është i ri (viti i 4), mund të them me plotë gojën që kemi studentë shumë të mirë, gjithmonë kërkuar, ambicioz dhe jam e sigurtë se çfarëdolloj zgjedhje do bëjnë ata në rrugëtimin e tyre, do të jenë shumë të suksesshëm dhe vlerë e shtuar për Shqipërinë. Ndërkohë ne kemi shumë studentë të huaj ku përqasja që kam me ta është edhe më personale, pasi dhe unë kam qenë studente e huaj në një shtet tjetër dhe i njoh nga afër vështirësitë me të cilat ata hasen.

–DHE SË FUNDI-SA E LIDHUR JENI ME VENDLINDJEN TUJ, BULQIZËN

(ndikimi i familjes dhe veçanërisht i babait tuaj Isufit-një emër i spikatur i elitës dibrane, në formimin tuaj)?

Zgjedhja e profesionit është e lidhur ngushtë patjetër me mamin tim. E kam zgjedhur shumë



herët, atëhere kur isha fëmijë dhe kur njohuria ime ishte që dentistët na rregullojnë dhëmbët e prishur.

Për fat të mirë nuk pata ndryshim mendimi as në kohën e gjimnazit dhe tani mendoj që nuk do të kishte profesion tjetër që të mund ta shikoja veten të përmbushur.

Unë, deri në moshën 14 – vjeçare kam jetuar në Bulqizë. Mund të them me shumë sinqeritet që pikërisht vitin para se të bënim kthimin përfundimtar në Shqipëri, pra verën e vitit 2022, kalova dy ditë në Fushë Bulqizë, ku ndjeva që rrënjët po më thërrisnin. Ndjesia që oksigjeni përshkoi mushkëritë deri në thellesi ishte e papërshkrueshme. Unë i përkas këtij vendi – thashë në ato momente.

Edhe pse larguar herët jam e lidhur me Bulqizën, sepse përveç rrënjëve atje kam dhe fëmijërinë, kohë e cila lidhet ngushtë me babain tim Isuf Koçin.

Si fëmijë nuk mund ti perceptoja sfidat që im atë ka kaluar në jetë, por mund të them që sfidat e mia kanë kaluar suksesshëm për çka unë mbaj në gjen dhe për shembullin e fortë që më ka dhuruar babai. Familjarët më thonë që në karakter përngjasojmë shumë dhe jam shumë krenare për këtë. Ndërkohë është i pashmangshëm dhe mendimi që sa i lumtur do të ishte babi në lidhje me kthimin tim, në lidhje me hapjen e një biznesi dhe për më tepër bashkëpunimin e mirë që kemi me motrën, Dr. Redjonën.

Ka shumë raste kur në klinikë gjenden vetëm pacientë nga Bulqiza ose me rrënjë nga Bulqiza. Kënaqësia është shumë ndryshe, pasi të kesh punuar për rreth 14 vite (pa shtuar dy vitet e praktikës si studente), me pacientë turq dhe vjen dhe jep gjithë eksperiencën tek bashkëatdhetarët dhe për më tepër ata që kanë njohur mamin apo babin, kjo të rrënjos më tepër dhe të jep kontributin e tij në përmbushjen e identitetit që i përket.

MUJO BUÇPAPAJ: “HALIL RAMA, KRIJUESI QË NGRITI FJALËN NË KULT TË MEMORIES KOMBËTARE

65 - vjetori i lindjes

ODA DIBRANE SI INSTITUCION VLERASH NË POEZINË E HALIL RAMËS

NGA NEXHBEDIN BASHA
GAZETAR & POET, KRITIK LETRAR

Autori i 30 librave vlerësohet me titujt “FISNIKËRIA E BASHKËSISË DIBRANE” dhe “MIRËNJOHJA TIRANASE”... Halil Rama – “Mjeshtër i Madh” dhe “Qytetar Nderi i Bulqizës”, profili krijues i të cilit është botuar edhe në veprat madhore të shkrimtarit filozof Zeke-ria Idrizi “Portrete shkrimtarësh” (fq.195-199) dhe “Jetëshkrime dhe vepra miqsh e shokësh të shquar” (fq.126-129) të Prof. dr. Hajri Shehut, në librat e tij të fundit “40 vepra letrare të 40 autorëve të skaner” dhe “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave”, vjen si promovuesi më i mirë i veprës letrare të shkrimtarëve dhe artistëve dibranë që renditen me elitën krijuese të kombit, si: Haki Stërmilli, Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Prof. dr. Bujar Kapexhiu, prof. dr. Fatmir Terziu, Ahmet Prençi, Dr. Hajri Mandri, Lutfi Hanku, Hysen Dervishi etj, si dhe të poetëve dibranë: Sakip Cami, Barie Cupi, Avni Ndreu, Demir Rusi e Hamdi Skeja dhe të monografive për Naim Plakun e Musa Riçkun ...



konkurruese dhe dinjitoze në tregun mediatik shqiptar, si evidentuese dhe promovuese më e mirë e vlerave të LANÇL dhe të historisë sonë kombëtare në tërësi, dhe të personaliteteve të saj të të gjitha kohërave.”, që ju dorëzua nga kryetarja e kësaj organizate Tatjana Parllaku Çarkaxhiu.

Në takimin promovues që u mbajt në Kinema “Maks Velo” Tiranë, mes qindra miqve, familjarëve e të afërmeve të këtij autori qenë dhjetra personalitete akademikë e të letrave që vlerësuan krijimtarinë e tij dhe veçanërisht librin “ODA DIBRANE”.

Vetë autori Rama, ndër të tjera tha se: “Në këto 35 vite të shoqërisë së lirë ka një fluks të madh potetësh, të vjetër e të rinj, poezinë e të cilëve e ndeshim thuajse çdo ditë në rrjetet sociale..., por mua, nga dilema për t’u bërë ose jo pjesë e kësaj oqeanopoezie, më ‘shpëtuan’ miqtë mi: Dr. Mujë Buçpapaj – ndër poetët dhe analistët shqiptarë më të vlerësuar nga intitucione e media prestigjioze ndërkombëtare; miku dhe bashkëpunëtori im i ngushtë Sakip Cami prej më se katër dekada, bashkëautorë i 6 monografive letare dhe zëvendës kryeredator i gazetës “Veterani”, ndër poetët, prozatorët dhe publicistët e mirënjohur tashmë; Emmy Krosi – poete, prozatore dhe ndër zërat më të spikatur të kritikës së sotme letrare, Shpendi Topollaj – publicist, poet, prozator dhe kritik i njohur letrar; poeti dhe poublicisti i njohur Nexhbedin Basha redaktorja e këtij libri – zonja fisnike e me inteligjencë të rrallë Nadire Kadaraku, si dhe kuadri dhe drejtuesi ekselente Irfan Dashi, etalon i ndershmërisë dhe përkushtimit qytetar (auror i dy librave), të cilët me ekspertizën e tyre më krijuan besimin për ta botuar këtë libër me poezitë dhe tregimet e mia të zgjedhura”.

VLERË SIME NGA PERSONALITETE KRIJUESE

MUJO BUÇPAPAJ: “Halil Rama është zëri që mban gjallë kujtesën dhe dinjitetin shqiptar përmes fuqisë së fjalës. Pena e tij ka ruajtur dinjitetin e fjalës shqiptare. Ai është ndër ata kri-

jues që në një kohë kur fjala shpesh humbet, e ka ngritur penën në kult të kujtesës dhe të ndershmërisë kombëtare. Me mbi tridhjetë libra në poezi, prozë, publicistikë e monografi, ai përfaqëson tipin e rrallë të intelektualit që ndërthur artin me përgjegjësinë qytetare dhe dashurinë e thellë për Atdheun. Në 65-vjetorin e tij dhe me rastin e botimit të librit më të ri “Oda Dibrane”, Halil Rama dëshmon sërish se për të letërsia nuk është zbulim fjalë, por akt shpirtëror dhe identitar...Në këtë vepër, fjala merr aromën e Dibrës – vendlindjes së tij – ku mikpritja, besa, burrëria dhe dashuria për njeriun janë rrënjë të thella të shpirtit shqiptar”.

PROF.DR. SAIMIR SHATKU: “Ky libër bart vlera shumëdimensionale, jo vetëm për lëndën tejet të pasur e të larmishme, por parasëgjithash për stilistikën e veçantë të këtij autori, gjuhën e pasur dhe mjetet shprehëse domethënëse. Kësisoj mund të konkludojmë se ky është një libër sa intrigues aq edhe mbresëlënës. Mesazhi këtu përcillet qartë sidomos tek poezia “ODA DIBRANE”: “Oda dibrane:/ Besa e burrit/, Qëndresa e trimit/, Përkrahja e mikut/, Çerdhe e patriotizmit/... Oda dibrane/ Mençuria e fjalës/ Urtësia e të moshuarve/ Fundi i armiqësive/ Kënaqësia e muhabetit/ Burim i humorit/ Shpërthimi i këngës/ Sheshi i kërcimit.../ Jehona e të qeshurit...” Në këtë poezi që autori e ka vendosur jo pa qëllim titull të librit evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku që shkrihen në kodet nëntekstuale nëpërmjet të cilave ai i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, maturia, etj”.

SHPENDI TOPOLLAJ: Halil Rama, mbetet një nga zërat më të fuqishëm dhe më të spikatur në evidentimin e vendit që Dibra dhe dibranët zënë në rrjedhat historike të Shqipërisë. I urtë dhe i thjeshtë në sjellje, dhe pa kurrfarë dëshire për t’u dukur, gazetari, poeti dhe shkrimtari i plot 30 librave, dhe do të shtoja; veprimtari Halil Rama, Mjeshtër i Madh, gjithë dijet, kulturën

dhe përvojën e tij, i ka vënë gjithmonë në shërbim të çështjeve madhore të Kombit tonë dhe domosdoshmërisë së instalimit të demokracisë të vërtetë. Është e njohur për lexuesin qysh herët veprimtaria e tij, si letrare, ashtu dhe publicistike, e cila pasqyrohet edhe te libri i tij me poezi dhe tregime që po paraqitet sot, me titullin ‘Oda Dibrane’.

EMMY KROSI: “Halil Rama është një krijues me mendim e individualitet të spikatur...Libri i tij i 30-të ‘Oda Dibrane’ është një zbritje në ‘terrenin e fjalës magjike’ – poezinë, si një hap të ri krijues pas veprës së tij publicistike. Përmes poezisë dhe prozës kërkon të gjejë dimensionin më shpirtëror të vetvetes. Libri ‘ODA DIBRANE’ ka strukturë të qartë dhe të menduar, i ndarë në gjashtë cikle tematike që përfshijnë historinë, vendlindjen, familjen, personalitetet, motivet popullore dhe meditet. Kjo ndarje tregon një krijues të ndërgjegjshëm për materialin e vet poetik, që kërkon të shprehë jetën, kujtesën dhe ndjenjën kombëtare në shumë drejtime. Në të gjenden motive baritore dhe folklorike që e lidhin me traditën e Dibrës dhe me poezinë e Naim Frashërit. Vargjet kanë ngrohtësi shpirtërore dhe tingëllimë melodike, që mbartin sineritetet e dritë brenda fjalës. Kështu Halil Rama arrin të bashkojë penën e publicistit me ndjeshmërinë e poetit, duke ndërtuar një univers ku bashkëtojnë historia, familja, dashuria, atdheu dhe meditet. Ai e ngre Odën Dibrane në institucion vlerash, duke sjellë një pasuri të re për letërsinë bashkëkohore shqiptare, që ruan rrënjët e traditës, por i flet me gjuhë të ndjeshme dhe moderne shpirtit të sotëm”.

NADIRE KARADAKU: “Libri ‘Oda Dibrane’ është kurorë e pjekurisë krijuese të autorit Halil Rama. Është një vepër e larmishme në tematikë dhe formë, që bashkon traditën me risinë, duke e bërë poezinë e tij të jetë e kuptueshme, e pastër dhe me ritëm të gjallë. Poezia e tij dallohet për gjuhën e thjeshtë, por të ngrohtë, që e bën librin të lexohet me një frymë dhe të lërë mbresa të thella tek lexuesi. Sidomos te poezitë familjare (“Nëna ime më e mira”, “Fjalëpak e punëshumë babai im”) dhe te ato kushtuar personaliteteve të njohura shqiptare si “Haki Stërmilli”, “Margarita Xhepa”, “Shefki Karadaku”, “Teodor Laço”, “Sokol Oll-dashi” e “Hazis Ndreu”. Në këto poezi shfaqet respekti i thellë i autorit ndaj figurave që kanë lënë gjurmë, duke gërrshetur frymën e poezisë shqiptare me elementë të poezisë botërore. Lirikat e tij mbështeten në filozofi jete, të ndërtuara mbi kultin e së bukurës dhe të përjetimit njerëzor. Në librin ‘Oda Dibrane’ Halil Rama shfaqet si poet i ndjenjës, i respektit dhe i përkushtimit, duke i dhuruar lexuesit një vepër që ndërthur dashurinë për familjen, traditën dhe artin.”

SAKIP CAMI: “Halil Rama, vjen me

(Vijon në faqen 12)

poezi



HALIL RAMA


- Oda dibrane:
Besa e burrit,
Qëndresa e trimit,
Përkrahja e mikut,
Çerdhe e patriotizmit.
- Oda dibrane:
Grumbullim njerëzish
Dashuria midis tyre
Këshilla e prindit
Vatër mikpritje...
- Oda dibrane:
Mençuria e fjalës,
Urtësia e të moshuarve
Fundi i armiqësive
Kënaqësia e muhabetit.
- Oda dibrane:
Burim i humorit
Shpërthimi i këngës
Sheshi i kërcimit..
Jehona e të qeshurit...
- Oda dibrane:
Zanafilla e ngjarjeve
Kuadrati i lodrave
Tempull për pleqtë,
Shkollë për të rinjtë.



ODA
DIBRANE



- Oda dibrane:
Dhe në Filadelfia
Mbledh "Bijtë e shqipes"
E ndërtoi Haki Çollaku
"Qytetar Nderi" i Dibrës..
- Oda dibrane:
Në festivale,
Çdo vit bashkë
Me këngë e me valle
Shqipëri e Madhe....



ODA DIBRANE SI INSTITUCION VLERASH NË POEZINË E HALIL RAMËS

(Vijon nga faqja 10)

këtë libër si poeti i ndjenjës, kujtesës dhe dashurisë që kthen jetën në poezi. Libri 'Oda dibrane' është një mozaik ndjenjash njerëzore dhe një pasqyrë e shpirtit krijues dibran, më shumë se një objekt kritik akademik. Në të dallohet dimensionin njerëzor i poezisë, ku dashuria për nënën, bashkëshorten, fëmijët, miqtë dhe idealet atdhetare formojnë boshtin tematik të veprës. Kjo tregon që poeti këndon me shpirt dhe e ndërton botën e tij poetike mbi ndjenjën, kujtesën dhe përkushtimin. Poezia e Ramës është intime dhe universale njëkohësisht, sepse lind nga përjetimet personale, por prek ndjenjën që u përkasin të gjithëve".

IRFAN DASHI: "Si dëshmitar në vetë të parë i procesit të ngjizjes e krijimit të pothuajse të gjithë krijimtarisë së Halilit, që nga monografi dhe deri tek libri që promovojmë sot "Oda Dibrane", dua të veçoj se në qendër të tij është poezia, kjo gjini e letërsisë ku bota e brendshme, ndjenjat e frymëzimi shprehen në vargje që dëshmojnë për pasionin, zellin e përkushtimin me të cilin Halili punon".

Si autori i këtij reportazhi unë (Nexhbedin Basha) do të thoja se poezitë dhe tregimet e zgjedhura të autorit Halil Rama ("Dashuri të stuhishme në plazhin e gjeneralit", Zonja me tri shtetësi dhe tri shtëtoi", "Rebelimi i qenit mavis"), etj nuk janë thjesht kombinim tingujsh apo shkrimesh, por trashëgimi, dritë dhe udhërrëfyes i shpirtit. Në 30 librat e Halil Ramës, fjala bëhet mbajtëse e kujtesës kolektive, përmbledh histori, ndjenja, heroizma dhe dhimbje të brezave të kaluar, duke jetuar dhe fluturuar tek lexuesi si një pasqyrë e së kaluarës dhe një dritë për të ardhmen.

Si autori i 30 librave ai vlerësua edhe me titujt "FISNIKËRIA E BASHKËSISË DIBRANE" dhe "MIRËNJOHJA TIRANASE"... Ndryshe nga ndonjë skeptik autodidakt që nga xhelozia e shfrenuar e akuzon dhe fyen në rrjetet sociale, unë dua të pohoj dhe vlerësoj se Halil Rama – "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi i Bulqizës", profili krijues i të cilit është botuar edhe në veprat madhore të shkrimtarit filozof Zekeria Idrizi "Portrete shkrimtarësh" (fq.195-199)

dhe "Jetëshkrime dhe vepra miqsh e shokësh të shquar" (fq.126-129) të Prof. dr. Hajri Shehut, në librat e tij të fundit "40 vepra letrare të 40 autorëve të skaner" dhe "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave", vjen si promovuesi më i mirë i veprës letrare të shkrimtarëve dhe artistëve dibranë që renditen me elitën krijuese të kombit, si: Haki Stërmilli, Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Prof. dr. Bujar Kapexhiu, prof. dr. Fatmir Terziu, Ahmet Prençi, Dr. Hajri Mandri, Lutfi Hanku, Hysen Dervishi etj, si dhe të poetëve dibranë: Sakip Cami, Barie Cupi, Avni Ndreu, Demir Rusi, e Hamdi Skeja dhe të monografive për Naim Plakun e Musa Riçkun të autorit Shaqir Skarra. Ndërsa në disa poezi të librit të tij të 30-të përcjell vlerat e Odës dibrane si institucion më vehte.

PËRFUNDIMI

Me intuitë profesionale dhe ndjenjë artistike, moderator i këtij eventi Dëfrim Met'hasani i dha këtij momenti gjallëri, emocion dhe dinjitet. Ai nuk

ishite thjesht moderator i një aktiviteti, por bashkëudhëtar në rrugën e kujtesës së Halil Ramës, duke i dhënë fjalës ritëm, zë dhe shpirt.

Në atë paradreke, dy Mjeshtër të Mëdhenj – Halil Rama dhe Dëfrim Met'hasani – u bashkuan në një fjalë të përbashkët: dashurinë për njeriun, për artin dhe për Shqipërinë. Po ashtu Kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtër, u bë pjesë e një momenti domethënës për kulturën dibrane dhe mbarëshqiptare – promovimit të librit "Oda Dibrane" të poetit e studiuesit Halil Rama.

Ajo tha se "ky vëllim, i botuar në 65-vjetorin e autorit, është një himn ndaj njerëzve të shpirtit, miqësisë dhe rrënjëve tona kulturore".

Vetë autori H.Rama shprehu mirënjohje për zërat që e ngritën në kult ndjenjën dhe në institucion vlerash ODEN DIBRANE – Liri Rasha e njohur si pasaporta artistike e Dibrës, këngëtar i njohur dibran Bledar Kaca dhe për aktorin, regjisorin e skenaristin e mirënjohur Llesh Nikolla që interpretoi artistikisht disa poezi të librit "ODA DIBRANE".

KRYETARJA E BASHKISË BULQIZË FESTIME MJESHTRI: “Krenare dhe mirënjohëse për kontributin e vazhdueshëm të intelektualëve dibranë, qofshin këtu apo larg si z. Vebi Musta, që prej vitit 1999 jeton në Amerikë, inxhinier miniere, por me zemrën gjithmonë në vendlindje”

promovimi



PERSONALITETE AKADEMIKE DHE TË LETRAVE VLERËSOJNË LIBRIN “FSHATI YNË LUBALESHI”

Ing. Vebi Musta promovon librin kushtuar vendlindjes

Salla “Aleks Buda” e Akademisë së Shkencave në Tiranë, kurrë nuk ka qenë më e tejmbushur sesa paraditen e së dielës të 14 shtatorit 2025. Mes qindra pjesëmarrësve, pëfaqësues të elitës dibrane në kryeqytetin shqiptar dhe të ardhur nga vendlindja e autorit Vebi Musta, të librit “Fshati ynë Lubaleshi”, qenë dhjetra personalitete akademike dhe të letrave që vlersuan këtë monografi.

Si redaktor i këtij libri, pas prezantimit të moderatorit tashmë të mirënjohur Defrim Methasani-Mjeshtër i Madh, pata fatin të flisja i pari. E me këtë rast, ndër të tjera theksova se në këtë libër janë përjetimet e letrarizuara të një intelektualit të mirëfilltë të lidhur pazgjidhshmërisht me vendlindjen e tij. Kjo për faktin se në faqet e këtij libri janë të detajuara: historia e sistemeve të qeverisjeve vendore në Republikën e Shqipërisë dhe më pas pozicioni gjeografik, etimologjia e emrit të fshatit Lubalesh, toponimet, origjina dhe përbërja e familjeve të 32 fiseve të tij, kontributi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, traditat, infrastruktura, zhvillimi i arsimit, kultura shpirtërore dhe ajo e jetesës, heronjtë dhe dëshmorët e Minierës Bulqizë - bij të këtij fshati e deri tek personalitetet që ai ka nxjerrë e me të cilët me të drejtë krenohet. Kësaj autori Vebi Musta, me mjeshtri artistike sjell në faqet e këtij libri, me freskinë dhe origjinalitetin e duhur personazhe të njohur e të panjohur të këtij fshati të një kohe të largët, por edhe të sotëm, ndër të cilët ja vlen të përmenden: Rushit Hysen Musta, i shkolluar në Izmir të Turqisë, që nga i burgosur në kohën e Zogut, drejtoi për disa vite pushtetin vendor si sekretar i Këshillit Nacionalçlirimtar dhe më pas i Këshillit Popullor të fshatit; Defrim Sadik Cani - shkrimtar, studiues, redaktor dhe kryeredaktor i disa gazetave e revistave; Rigels Rajku (NOIZY), reperi i mirënjohur shqiptar me origjinë nga Lubaleshi; Arbana Osmani, mbesë e fshatit Lubalesh, vajza e Flutura Imer Stojkut, si moderatore emisionesh televizive dhe si aktore e shquar; Altin Sulku - ndër këngëtarët popullor më të preferuar nga publiku; Irena Metalla, bijë e prindërve Remzi Metalla dhe Mimoza Metalla (Murgu), për pjesëmarrjen në Eurovizion me “Shkodra Elektronike”, e disa të tjerë..

Ngrohtësisht dhe me duartrokitje të fuqishme u prit edhe përshëndetja e kryetares së Bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri. Ndër të tjera ajo shprehu kënaqësi të veçantë që ishte në Akademinë e Shkencave, në promovimin e librit “Fshati ynë Lubaleshi” të autorit Vebi Musta, duke e vlerësuar si një botim me shumë vlerë, që i kushtohet një fshati me histori të pasur, me 32 fise, 22 kulla dhe plot intelektualë që i kanë dhënë shumë zonës dhe më gjerë. “Krenare dhe mirënjohëse për kontributin e vazhdueshëm të intelektualëve dibranë qofshin këtu apo larg si z. Vebi, që prej vitit 1999 jeton në Amerikë, inxhinier miniere, por me zemrën gjithmonë në vendlindje”, tha kryebashkiakja Mjeshtri.

Prof. dr. Gafur Muka, një personalitet i shkencës, i njohur si pedagog i disa universiteteve, si publicist dhe poet pohoi se si një nga lexuesit e parë, pati kënaqësinë të informohet për shumëçka nga Lubaleshi, nisur prej kohës që autori Vebi Musta mbart në libër, duke kaluar nëpër paisazhin e bukurive natyrore, duke u pasuruar me historinë e fiseve, duke u njohur me zakonet, doket, traditat deri te arritjet e banorëve të Lubaleshit në vite.

“Këdo që të pyesësh se cili është për të vendi më i bukur në botë, do të përgjigjej pa asnjë hezitim: Vendlindja. A është i vërtetë ky pohim? Provo të bësh portretin e vendlindjes dhe do konstatosh se asnjëherë nuk ke bërë atë që dëshiron. Duke lexuar librin ‘Lubaleshi, fshati ynë’ të Vebi Mustës, e kupton menjëherë që autori ka dëshirën e madhe, inspiruar edhe prej mallit të mërgimtarit, ta japë sa më të plotë e, njëkohësisht, sa më të bukur portretin e vendlindjes së tij. Jo vetëm informacionet e shumta, dëshmitë e përjetuara, kujtimet e përmalluara por edhe narracioni i përdorur nga autori e bëjnë këtë libër të dashur për lubaleshasit dhe me vlerë për të gjithë ata që e lexojnë”, vlerëson Prof. dr. Gafur Muka që është edhe recenzent i kësaj monografie shumëdimensionale. Sipas tij, ky libër, siç e pohon dhe vetë autori, është ‘fillimi i ndërtimit të një rruge që nuk mbaron kurrë’. Ndaj dhe uron që në këtë ‘rrugë’ të ecin gjithë lexuesit e këtij libri ku, me siguri do gjejnë shumëçka që ata dëshirojnë, për tu motivuar ta çojnë më tej “ndërtimin” e saj. Akademik Adem Bunguri - Drejtor institutit të Arkeologjisë u ndal veçanërisht në profilin intelektual dhe krijues të autorit Vebi Musta.

Ing. Agim Vargu, ish-drejtor i Minierës së Kromit Bulqizë dhe funksionar i lartë i ALBKROM në Tiranë, si bashkëfshatar dhe bashkohës i autorit Vebi Musta, ndër të tjera vlerësoi se “Fshati ynë Lubaleshi” është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që zë vend meritë në fondin e letërsisë sonë dokumentare dhe si i tillë ja vlen të lexohet dhe të pasurojë bibliotekat tona. Ai evidencoi sidomos përshkrimin e arkitekturës së veçantë të kullave tri katëshe të fshatit Lubalesh, ndërtimin e xhamisë, ritualit e dasmave e morteve, jetën kulturore e aristike dhe shoqërore, drejtimi i fshatit Lubalesh në vite, dëshmorët e LANÇ e të rënë në minierën e kromit Bulqizë nga ky fshat, që zënë vendin e merituar në faqet e këtij libri.

Për vlerat ideoaristike të kësaj monografie folën shkrimtarët dhe studiuesit e njohur të letërsisë Defrim Cani e Aqif Puca.

Emocione të fuqishme ngjallën tek pjesëmarrësit në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave edhe përjetimet e Demir Osmanit, sin ë nga përaqësuesit dinjitozë të elitës dibrane në metropolin shqiptar.

NDERIMI I VEBI MUSTËS ME TITULLIN “AMBASADOR I PAQES” DHE ME ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE NGA SHOQATA BULQIZA

Si një nga përfaqësuesit e elitës dibrane, filimisht në Bulqizë - një nga inxhinierët dhe drejtuesit më kompetent, të talentuar e të suksesshëm të Minierës së Kromit, në Tiranë ku për disa vite demostroi përgatitje të lartë profesionale e shkencore në instucione të rëndësishme dhe veçanërisht si Noter Publik në Florida-SHBA ku ka emigruar dhe punon e jeton familjariht prej çerek shekulli (që nga viti 1999), Vebi Musta e përjetoi si krejt të vçantë këtë ditë të promovimi të librit të tij “FSHATI YNË LUBALESHI”.

Jo vetëm nga pjesëmarrja massive e nga vlerësimet e personaliteve akademike e të letrave, por edhe nga nderimi që i bëri Federata e Paqes Universale Shqipëri, duke i dhënë titullin Ambasador i Paqes”, titull që ja dorëzoi në mënyrë solemne Kryetari i Këshillit të Paqes Tiranë, avokat Kastriot

Selita - një emër i mirënjohur i drejtësisë shqiptare.

Më parë ai u vlerësua me “Çertifikatë Mirënjohje” edhe nga Shoqata Atdhetare kulturore “Bulqiza”, të cilën ia dhanë dy nga mësuesit e nderuar të tij, kryetari i kësaj shoqate Bashkim lami dhe sekretari Hamit Dervishi.

E me këtë rast, Defrim Methasani që e moderoi këtë event me mjeshtëri të rralla artistike evidencoi edhe mbështetjen që I kanë dhënë autorit Vebi Musta, bashkëshortja e tij Pashe Musta (Gazidede), një zonjë me inteligjencë e finikëri të rrallë dhe tri vajzat Sonila, Miranda dhe Jorida që punojnë në pozicione të rëndësishme në Florida, SHBA.

VEBI MUSTA KA KRIJUAR MUZEUN E FJALËS PËR VENDLINDJEN E TIJ, LUBALESHTIN

Libri i Vebi Mustës “Fshati ynë Lubaleshi” para së gjithash është dëshmi e përjetimit prej tij të brengës së mos shkrimit më parë të historisë së vendlindjes, të cilën më në fund e finalizoi, duke e lënë atë si testament fjale për bashkëkohësit dhe për brezat e ardhshëm.

Që në faqet e para të librit të autorit Vebi Musta ndjehet krenaria e familjes dhe e 32 fiseve të Lubaleshit, krenaria e vendlindjes, e krahinës dhe krenaria kombëtare. Një krenari e bazuar tek historia, puna dhe arritjet e njerëzve trima, punëtorë dhe bujarë të familjeve e fiseve të fshatit të tij, Lubaleshit. Në këtë libër lëvrijnë personazhe realë të të gjitha kohërave. Është dashuria për vendlindjen ajo që e nxiti autorin Vebi Musta për të ndërmarrë këtë sipërmarrje sa të bukur aq edhe të vështirë. Dhe ia ka arritur qëllimit sepse i ka qëndruar besnikërisht sentencës, se “pa e ditur që nga kemi ardhur nuk e kuptojmë se ku jemi, dhe nuk arrijmë të mendojmë se ku do të shkojmë”.

Njeriu instiktivisht është i lidhur me atdheun e vetë, i cili padyshim fillon nga familja e vendlindja e tij. Pikërisht kjo sentencë shtjellohet më së miri nga autori V.Musta në librin “Fshati ynë Lubaleshi” (monografi letraro-artistike).

Autori Vebi Musta, si bir i një familje me tradita atdhetare nga Lubaleshi, që u mësua që në fëmijërinë e herëshme me traditat e familjes, të fisit e të fshatit të tij emërndritur në historinë tonë kombëtare, në këtë libër vjen me “pasaportën” e zgjuarsisë natyrale, dhuratë e genit dhe natyrës së vendlidjes së tij me resurse të shumta njerëzore e turistike dhe si një intelektual i mirëformuar, me vitalitet, talent e shpirt të rrallë krijues.

Vebi Musta vjen me këtë libër që u promovua më 14 shtator 2025, në Akademinë e Shkencave, Tiranë, si trashëgimtar i një familje patriotike dibrane dhe si kontribues i palodhur në ruajtjen dhe lartësimin e vlerave dhe traditave më të mira të familjeve të 32 fiseve të fshatit të tij të lindjes, Lubaleshit.

Në librin e tij është historia e një fshati që ka nxjerrë dhjetra figura autoritare me vlera përbashkuese kombëtare, që me ndikimin e tyre të vazhdueshëm përparimtar ngjallin besim dhe shpresë për të ardhmen...., është referenca më domethënëse që simbolizon dashurinë dhe përkushtimin për vendlindjen, si leitmotiv i përhershëm i mallit dhe dashurisë që krijon jeta në emigrim.

Në këtë libër dallohet forca metaforike dhe formimi intelektual e kulturor i autorit V. Musta, i cili ka krijuar kështu muzeun e fjalës për vendlindjen e tij, Lubaleshtin.

promovimi


Libri “Po kthehem në Hotesh”-
monografi, është një udhëtim i
shpirtit drejt vendlindjes

FESTIME MJESHTRI – KRYETARE E BASHKISË BULQIZË:
“Ky botim është pasqyrë e jetës së një mësuesi të përkushtuar që nuk u nda asnjë ditë nga shkolla duke dhënë mësim dhe duke drejtuar me përgjegjësi institucionet arsimore të Matit e Dibrës”

TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU -KRYETARE E OBVLV: “Ne krenohemi me Skënderin, i cili sot punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ai dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun”

Skënder Murrja promovon librin “Po kthehem në hotesh”

Libri i autorit Skënder Murrja “PO KTHEM NË HOTESH” që u promovua më 12 tetor 2025 në Akademinë e Shkencave në Tiranë, me praninë e qindra pjesëmarrësve nga vendlindja e autorit dhe nga miq e shokë të



shumtë të tij me banim në Tiranë, Peshkopi e Durrës, u vlerësua për mesazhet që përcjell mësuesi veteran me kontribut të pandërprerë në edukimin mijëra nxënësve në disa shkolla të qarkut të Dibrës.

Fillimisht u ndoq me interes të veçantë dokumentari (I përgatitur nga unë H.R) që pasqyrore me mjeshtri e art shembullin e një mësuesi që me pasionin për dije dhe dashurinë për nxënësit punoi një jetë tërë. Ishin këto dije të thella e të qëndrueshme që ai i për mishëroi dhe përçoi me përkushtim e dashuri, të cilat do t'u shërbenin qindra e mijëra nxënësve të tij, nga Derjani i Matit, Luznia, Muhurri, Çidhna, Katër Grykët e Bulqiza, si arma më e fuqishme për jetën. 42 vite kontribut pa ndërprerje, si mësues dhe

drejtor i disa shkollave në tre rrethet e qarkut Dibrë, të finalizuara në këtë libër, u vlerësuan maksimalisht dhe nga kryetarja e Bashkisë Bulqizë Znj. Festime Mjeshtri. Ajo e vlerësoi këtë botim si pasqyrë të jetës së një mësuesi të përkushtuar që nuk u nda asnjë ditë nga shkolla duke dhënë mësim dhe duke drejtuar me përgjegjësi institucionet arsimore të Matit e Dibrës.

Luljeta Prençi, drejtore e gjimnazit “Ibrahim Rugova” Kamëz e vlerësoi librin “Po kthehem në Hotesh” një prozë memorialistike që për nga zhanri, është një autobiografi e ndërthurur me kujtime dhe pasazhe të tjera që i kalojnë kufijtë e një autobiografie të mirëfilltë. Kjo sipas saj për faktin se në këtë libër është një jetë, bilanci i së cilës e bën krenar këdo; një jetë përkushtuese dhe që afirmon personalitetin e individit përmes punës. Kryetarja e Org.Bashkua të Veteranëve të LANÇ e pasardhësve, Znj. Tatjana Parllaku – Çarkaxhiu, ndër të tjera në fjalën e saj tha se OBVLV krenohet me Skënderin, i cili sot punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Pikërisht për këtë kontribut madhor ajo dhe Nënkrjetari i kësaj organizate Muharrem Gjoka – Mjeshtër i Madh i akorduan mësuesit veteran Skënder Murrja “ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE”.

Demir Osmani që ka pasur fatin që me Skënder Murren të jenë së bashku nxënës në gjimnaz, në Institut, mësues në Mat e Dibrë, ndër të tjera evidentoi faktin që “Skënderi i dha arsimit në Dibrë rininë, pjekurinë, burrërinë dhe i mori mirënjohjen, dashurinë dhe respektin e shumë brezave.

Në të njëjtën linjë e vlerësoi mësuesin veteran Skënder Murrja edhe bashkënxënësi e bashkëstudenti i tij në gjimnazin e Durrësit e në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, Bashkim Lami, i cili në cilësinë e kryetarit të Shoqatës Atdhetare “BULQIZA” i dha atij “ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE”.

Faik Khani, ndër të tjera e vlerësoi Skënder Murren si veprimtar shoqëror për kohën që ishte sekretar i Komitetit të Rinisë Luzni e në ushtri, anëtar i Plenumit të Rinisë Dibrë dhe kryetar i Sindikatës së Arsimit Bulqizë. Prof. dr. Arif Murrja – pedagog në Universitetin Bujqësor Kamëz u ndal te një aspekt i veçantë: vendlindja në librin e Skënder Murren... Sepse, me këtë libër ai na kujton se vendlindja nuk shuhet kurrë nga zemra e njeriut. Ajo mbetet udhërrëfyes shpirtërore që na udhëheq në çdo hap të jetës. “Libri ‘Po kthehem në Hotesh’- monografi, është një udhëtim i shpirtit drejt vendlindjes. Që në hyrje autori na ndal te emri i Hoteshit dhe etimologjia e tij. Ai na kujton se vendlindja nuk është thjeshtë hapësirë gjeografike, por një trashëgimi kulturore dhe shpirtërore, që duhet ruajtur me kujdes”, -tha ndër të tjera Prof. dr. Arif Murrja. Figurën e mësuesit Skënder Murrja e lartësojnë shumë cilësi, por ato që shfaqen më dukshëm, janë sinjeriteti dhe bujaria, mikpritja dhe dashuria që ushqen për të gjithë njerëzit.

Skënder Murrja është dhe një veprimtar i palodhur shoqëror. Ai, bashkë me shumë shokë të vjetër mësues të Dibrës dhe jo vetëm, edhe si anëtar i kryesisë së OBVLV, bën një punë të mirë atdhetare për njohjen dhe vlerësimin e Luftës e të heroizmit shqiptar në shekuj për çlirimin dhe mbrojtjen e vendit nga pushtuesit.

Shkolla e Viçishtit, 28 dhjetor 1944

(Nga kujtimet e Skënder Menzelxhiut)

PËRGATITI PËR BOTIM SAKIP CAMI

Më 27 dhjetor 1944, Fehmi Kodra emërohet mësues në Viçisht të Dibrës. Skënder Menzelxhiu në ditarin e tij, kujtime nga LANÇ, botuar në vitin 1974, faqe 51 shkruan: “Gëzimi im sot është i papërmbajtur sepse më në fund pas kaq ndërhyrjesh arritëm ta plotësojmë shkollën e katundit Viçisht me mësues. Edhe më tepër i gëzuar ndjehem sepse mësues është vëllai i shokut tonë të ngushtë, dëshmorit Siri Kodra.” Faqe 51 Shkolla e Viçishtit u inagurua me 28 dhjetor 1944. Mësuesi Fehmi Kodra më vuri në dijeni për gjendjen e shkollës. Është e para shkollë e inaguruar pas çlirimit. Musa Xheka, që i vjen ndoresh, ka rregulluar 9 banka dhe ka bërë një dërrasë të zezë me copa dërrasash të bashkuara Fehmi Kodra ka shkruar në Dibrë të Madhe dhe ka siguruar bojë të zezë për bankat dhe dërrasën e zezë. Ka shkruar edhe në Tiranë dhe ka siguruar libra, fletore dhe lapsa. Populli, inagurimin e shkollës e festoi me gëzim dhe hare. Nga curlet dhe lodrat atë ditë gjëmuan malet. Prindërit kishin marrë për dore fëmijët e tyre që fillonin shkollën atë ditë. Fëmijët e dëshmorit dhe komandantit të çetës së Golobordës Ahmet Cami, Dritën dhe Fehmijen, atë ditë e shoqëronte xhaxhai i tyre Kurt Cami. Ndërsa Fiqiri Cami, djali i dëshmorit Musa Cami kishte ardhur vetëm. Ndjekin shkollën e sapohapur 31 nxënës, nga këto 8 vajza. Vazhdon ditari: Me datë 4 mars 1945 shkova në Viçisht të shtëpia e Sulë Camut, sekretar i kështillit të katundit. Këtu bëmë mbledhjen e kështillit dhe trajtuam problemet e asistencës sociale. Më pas



bëra një vizitë te shkolla ku më priti mësuesi Fehmi Kodra. Ndërsa kështilli i rinisë antifashiste me shokët Mois Ahmet Cami, Sinan Seit Markja, Mane Rrem Cami, Shaqir Adem Cami punon shumë mirë. Të gjithë i duan këta të rinj dhe ua dëgjojnë fjalën. ... Përpjekjet për hapjen e shkollës në Viçisht kishin filluar që në vitin 1940 nga biri i këtij fshati normalisti Fasli Cami. Vrasja e tij nga fashistët italianë në prill të vitit 1941 vrau edhe këto përpjekje për hapjen e shkollës, të cilat u ringjallën e u bënë realitet vetëm një muaj pas çlirimit të vendit. Sot shkolla 9 vjeçare Viçisht mban emrin e Fasli Camit, mësuesi i parë dëshmor i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Kushtuar Hafiz Sherif Langut, delegatit të pavarësisë, të cilit ju mohua kontributi atdhetar për 50 vjet me rradhë

poezi

Rrezato o Nderi i Kombit

Kushtuar Hafiz Sherif Langut, delegatit të pavarësisë, të cilit ju mohua kontributi atdhetar për 50 vjet me rradhë



NGA SAKIP CAMI

1.
Nga Qafa e Buallit
Varg të Nandë Malet
Sanxhaku i Dibrës
Drini që nuk ndalet.
2.
Dibra të lindi, Dibra të rriti
Nip veziri, bir petriti
Bir dëshmori, bir Perëndie
Ti, dalzotas i ksaj Shqiptarie .
3.
Osman Langu, Jusuf Skikuli
As edhe vdekja dot nuk i shkuli
Luftë banë deri në Manastir
Dy imamë, dy xhevahirë.
4.
Shpirti s’i del babë Osmanit
Për Mirvetin dhe Nebikën
Për Edipin dhe Gafurin
Që t’mos njohin të keqen dhe frikën.
5.
Për Sherifin dhe Shabanin
Sot ma shumë thërret vatani
Për Dautin dhe Rifatin
Që të mos shuhet nderi e nami.
6.
Dajë Selimi President
E nis nipin në Stamboll
Të shkollohet pors i mbret
Në më të mirin Universitet
7.
Babë Osmani, lënë porosi
Të shkollohet për teologji
Sepse feja dhe atdheu
Për shqiptarin’ janë një.
8.
Pas studimeve në Stamboll
Për drejtësi e teologji
Sherif Langu kthehet në Dibër
Si imam dhe si kadi
9.
Si imam dhe si kadi

- Ai shquhej për drejtësi
Para se të jesh fetar
Mbi të gjitha je njeri.
10.
“Bashkimi”, klub atdhetar
Atë e zgjodhi kryetar
Me abetare shpi më shpi
Pleq, gra edhe fëmijë
11.
Gjuha shqipe në Kongres
U vendos gjuhë e parë
Përfaqësuesi n’Manastir
Nga”Bashkimi”, vendimtar
12.
Luftoi me pushkë
Ndriçoi me dije
Deri kur erdhi pavarësia
Në çdo skaj shqiptarie.
13.
Për në Vlorë, në kuvend
Dibra e zgjodhi delegat
Që nga Dibra deri në Vlorë
Udhëtoi ditë e natë.
14.
Në nëntor më tridhjetë
Bashkë me Isa Boletinë
Ismail Beu ata i prit
Siç pret vëllai, vëllain e tij
15.
Ish i ditur, ulema’
Kryetar i Ulemasë
Shqiptarinë mbi të gjitha
Avokat i fukarasë.
16.
Komuniteti mysliman
Atë e zgjodhi kryetar
Delegatit të pavarësisë
I ndrit fjala porsi ar.
17.
E dënoi fashizmin e zi
I ndihmoi çlirimtarët
Por kur dolën në liri
E dënuan mëkatarët.
18.
Dhe kaluan pesëdhjetë vjet
Që të ngrihesh në piedestal
Rrezato o Nderi i Kombit
Lartëso porsi mal.



Klithma e zemrës

NGA BARIE CUPË

Nga rrëmujë e pagjumësisë,
më kanë mbërthyer vizatime të padukshme
fjalësh,
për trarësh varur ëndrrat e mbetura,
perdja e natës mbulon imazhe,
zogj të shurdhër jemi.
mendimet glasen si pagëzim i fatit,
si hutë mbi krye krroket paudhësia,
një pikë errësire na e pin shikimin,
digjen gërmat me flakët e vetmisë.
as hijet nuk na njohin në vizatime të tilla,
ia mësym kohës fajet,
orët na përcjellin si kujtime të ngatërruara,
në zgjime të pakryera,klithma e zemrës,
psherëtimë që s’bëzan.
të ngrira pigmentet e ujit në pikturën e vjetër,
suva të njomura me shira stinësh,
buzëqeshje të etura,rrëzohen humbëse,
në këtë rehati memece,
duhen buzë hëne,
të ndryshket errësira në pikturën tënde.

Udhëtim në kujtesë

Mbërriti e sotmja me vela varkash të humbura,
skutave të një ëndrre,udhëtim i gjatë,
iu përflak syve,
koha që i vodhi dashurinë,
qielli shkrin kujtesë,
në pasqyr’n e hënës si një qelqurinë.
Shi i ftohtë përplaslet mbi ditarin e grisur,
gjinjsh të natës,pin qumësht një fantazmë,
ijeve të jetës shpërthen klithma e gërmaeve të thyera,
ndërsa fjala zgjohet,
angullimesh të ngjyera.
Niset e sotmja sërish me vela varkash të humbura,
shkundur gjithë malli,në një prag të huaj,
metafor’e fatit kërkon shpëtim,
skërmiten orët në heshtje,varkat ikin në pakthim.

ARTI LETRAR BASHKON BREZAT
NË FAMILJEN "ALLIU" TË BULQIZËS

NGA BASHKIM LAMI*

Me 6 Dhjetor 2025, Kryesia e "Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza" organizoi në Tiranë, në kinemanë "Maks Velo", prezantimin e krijimtarisë së poetëve, Arben Alliu që solli për lexuesit librin me poezi "Frymoj me ty Vendlindje" dhe Anxhela Topalli Alliu, që solli librin e saj të parë me poezi "Ngjyrat e Shpirtit". Gjithë aktiviteti kushtuar dy poetëve në një familje ishte një orë poetike, që rrezatoi art dhe plot emocione në sallën e mbushur me shkrimtarë, poetë, intelektualë, miq, shokë e familjarë, që ndoqën me kërksheri prezantimin e moderuar mjeshtërisht nga gazetari e shkrimtari Halil Rama (Mjeshtër i Madh), i cili, gjatë gjithë kohës, solli për të pranishmit ngrohtësi, komunikim të natyrshëm dhe një atmosferë e gjallë festive. Takimi filloi me ekzekutimin e hymnit tonë kombëtar, ku pjesëmarrësit u ngritën në këmbë. U mbajt një minutë heshtje për nderimin e 15 vjeçarit bulqizak Erion Boba, që humbi jetën këto ditë, pas goditjes me thikë në zemër nga bashkëmoshatare i tij, nxënësi në shkollën "Dom Nikollë Kaçori" në Durrës.

Për pjesëmarrësit në takim u shpalos në monitor dokumentari shkurtër për jetën e veprimtarinë e poetëve Arben & Anxhela, që u ndoq me shumë vëmendje. Mësuesja veterane e letërsisë Nafije Jella, që është dhe redaktore e librave "Frymoj me ty vendlindje" dhe "Ngjyrat e Shpirtit", të sapo dalë nga shtëpia botuese "Print-AL" në Tiranë, theksoi në fjalën e saj, se mënyra që përdor poeti Arben Alliu, në librin "Frymoj me ty Vendlindje", sjell një lidhje të veçantë mes njeriut dhe tokës së tij, një frymëmarrje të përbashkët me rrënjët, gjurmët dhe heronjtë që bënë historinë e atyre viseve. Poetët me stil të bukur kanë përdorur figura letrare metafora, krahasime, personifikime, dialogje, etj,

RRËFIM NARRATIV ME NDJESI TË
KËNDSHME
DHE EMOCIONE TË FORTA I POETES
ANXHELA TOPALLI ALLIU

që e ndalojnë lexuesin për të shijuar anën e bukur të mesazheve që sjellin poezitë, që janë rrëfime të thjeshta e të singerta, që burojnë nga zemra. Autorët e ndërtojnë poezinë mbi nostalgjinë për vendlindjen, për fëmijërinë dhe për kujtimet që mbeten të paharruara.

Kryetari i "Shoqatës Bulqiza", z.Bashkim Lami foli për familjen "Alliu", që në disa breza ka ndërtuar jetën me punë e djersë dhe ka qenë pjesë e qëndresës kundër pushtuesve të huaj. Edhe Arbeni është vazhdues i traditave më të mira, një punëtor i palodhur dhe vizionar e i talentuar për të vendosur në vargje të shkurtër e strofa të rim-

duket se krijimtaria e saj do të vazhdoi edhe edhe më tej në libra të tjerë. Ajo realitetin që jeton dhe të bukurisë e vendos në poezi dhe me penel në piktura. Poezitë e Anxhelës mbartin butësi e delikatesë, që lënë gjurmë të thella. Anxhela ka dhuntinë të jetë një infermjere humaniste, një poete plot sharm dhe emocione, por edhe një piktores që mbush telajo me ngjyra të jetës.

Presidenti i "Shoqatës Bulqiza", prof. dr. Islam Dauti në fjalën e tij vlerësoi krijimtarinë e poetëve dhe rëndësinë që ka vendosja në këto libra e heronjve të Bulqizës e më gjërë dhe të bukurive

uara me kujdes në tre librat me poezi që ka botuar. Natyrisht që tek ky libër që prezantojmë "Frymoj me ty vendlindje" gjejmë një rritje cilësore të krijimtarisë së tij. Poetja e re korçare Anxhela Topalli gjeti në strehëzën e saj të re, bashkëshortin Mikel, i suksesshëm e kampion në sportin e boksit dhe vjerrin poet me përvojë. Falë talentit të saj që ajo ka shpalosur qysh në vitet e shkollimit për pikturën dhe poezinë, arriti të botojë librin e saj të parë "Ngjyrat e Shpirtit", ku shprehen idetë e saj rinore plot dritë, emocione, ngjyra të brëndëshme e figura artistike që

• Një orë poetike, që rrezatoi art dhe plot emocione në sallën e mbushur me shkrimtarë, poetë, intelektualë, miq, shokë e familjarë, që ndoqën me kërksheri prezantimin e moderuar mjeshtërisht nga gazetari e shkrimtari Halil Rama (Mjeshtër i Madh), i cili, gjatë gjithë kohës, solli për të pranishmit ngrohtësi, komunikim të natyrshëm dhe një atmosferë e gjallë festive.

të natyrës dhe të sakrificave për jetën. Profesori psikologjisë dr. Jashar Demiri, drejtor i departamentit të letërsisë e arteve pranë "Shoqatës Bulqiza", vlerësoi vendosmërinë e poetit Arben Alliu për të shpalosur publikisht idetë e tij nëpërmjet poezive, që aq bukur e paraqet vendlindjen tonë me të mirat dhe problemet, që i shqetësojnë atë popull fisnik. Duke i nderuar poetet tanë si Arben Alliu, ne nderojmë traditat, kulturën, vlerat, qytetarinë, shkurt: Vendlindjen! Në emër të kryesisë së "Shoqatës Bulqiza", poetëve iu dorëzuan certifikata mirënjohjeje. Kryetarja e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇL, znj. Tatjana Parlaku, zv/kryetari OBVL-së, Muharrem Gjoka, në vijim të traditës së nderimit të pasardhësve të denjë të familjeve atdhetare, i dorëzoi poetit certifikatën "Nderi i OBVL", duke vlerësuar kontributin e tij qytetar dhe krijimtarinë me ndjeshmëri të thellë kombëtare.

Poetja dhe kritikja letrare Emi Krosi, u ndalua te stili, metaforat, ndjeshmëria dhe rrëfimi emocional i autorit, që e bënë poezinë tërheqëse. Vlerësime të veçanta për librin e Anxhelës Topalli Alliu shprehu edhe poetja Mimoza Dilaver Kurti, që renditi me kujdes mënyrën se si i kanë ndërtuar poezitë autorët. Për rëndësinë e krijimtarisë së të dy autorëve folën edhe shkrimtari e historiani Sakip Cami, poeti Perikli Shuli, ish ushtaraku Azis Keta, ish drejtuesi kulturor Aqif Puca, etj.

Takimi mori ngjyrë festive falë këngëtares së talentuar të muzikës popullore Liri Rasha, që interpretoi për të pranishmit dy kolazhe me muzikë të zgjedhur dibrane.

Takimi vazhdoi me recitimet e disa poezive të zgjedhura nga poetet Anila Kodra, Sanie Degjoni Ndreka, Miranda Troci Derti, Moza Shehi, si dhe Megi Musai, një vajzë e talentuar studente, që recitoi aq bukur dhe me ndjenjë.

Në fjalën e tij, poeti Arben Alliu falenderoi të pranishmit për vlerësimet, duke theksuar: "Mendimet tuaja i marr si një mesazh të qartë: të punoj më shumë, të përmirësoj cilësinë në krijimtarinë time." Ndërsa poetja dhe piktoresja e re, Anxhela Topalli Alliu, u shpreh me një thënie filozofike, që përmbledh harmoninë mes dy talenteve të arteve të saj: "Poezia është një pikturë e shpirtit, dhe piktura është poezi e shpirtit."

Mirë u pafshim në takime të tjera!

*Kryetar Shoqatës Atdhetare Kulturore "BULQIZA"

TRASHEGIMIA POPULLORE

Vallja e grave të Bulqizës duhet dërguar në UNESCO

DHURATA KOLA KALOSHI

Katër gra kërcejnë vallen karakteristike të grave të Bulqizës. Vallja kërcehet nga katër gra me motive origjinale, ku dy gratë (e para dhe e fundit) e tërheqin vallen herë majtas, herë djathtas dhe formojnë koreografinë e lëvizjeve. Herë pas here ulen e ngrihen, me një shkathtësi dhe elegancë, për t'u admiruar, duke kombinuar hapat me mjeshtëri. Dy gratë e mesit janë "mbajtëset"; ato herë lëvizin para, herë mbrapa. Vallja nuk ka as fillim, as fund.

Të dyja "mbajtëset" ndjekin hapin e secilës soliste, duke e ndarë kuartetin e valles në dy çifte grash. Pra, në thelb të koreografisë janë dy çifte grash që kërcejnë, secila me hapin e saj, por me motiv të njëjtë.

Çdo tentativë për të ndryshuar numrin e vallëtareve, koreografinë apo elemente të tjera të valles, prish origjinalitetin e saj. E theksoj këtë, nisur nga disa filmime që kam parë në YouTube."Veshja në foto është origjinale, por duket si e një dite të zakonshme. Veshja e plotë përmban edhe vargun me "paret" prej sermi dhe disa elementë të tjerë që e bëjnë të dallohet nga veshja e përditshme.

Mua më ka intriguar gjithmonë kjo valle: në dukje e thjeshtë, por jo e lehtë për t'u kërcyer. Mendoj se kjo valle duhet studiuar. Përmban elemente karakteristike që nuk hasen askund në krahina të tjera dhe, ndoshta, pse jo, të dërgohet në UNESCO. Ndaj origjinaliteti i saj duhet ruajtur

me xheloz. Në vlerësim të komentit të Dhurata Kaloshit në facebook, Engjellushe Methasani shkruan se "Vallja e Bulqizës, identiteti i kulluar i shpirtit artistik bulqizak, unike në llojin e saj. Veshja bulqizake tërë hire në trupin e vajzës dhe gruas bulqizake. Të gjitha pjesët e saj ne shërbim të bukurisë, të thjeshtësisë, të nurit, të të moralshmes, të së denjë, të së palodhshmes. Është krenari që këto dy perla të identitetit bulqizak jo vetëm që janë ruajtur me fanatizëm por po rishfaqen dhe më me forcë si nje shpirt i ringjallur, në çdo ngjarje gëzimi".



Valle e grave në Bulqizë: (Nga e majta në të djathtë) Kërcejnë: Bibe Demiri; Rrushe Laçi; Ferite Peti; Zëlie Hida.



bulqizë
Gëzuar Vitin e Ri

2026!

Ecuria e punës në veprimtarinë minerare të zonës së Bulqizës gjatë vitit 2024-2025

Ju urojmë Gëzuar Vitin e Ri 2026, të gjithë punonjësve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineralit të kromit, veçanërisht atyre të fabrikave të pasurimit të kromit në Bulqizë, Kalimash, Gjakovë, punonjësve në minierat e kësaj shoqërie në Qafë-Lamë, Klos, Tërnove Bulqizë, Kalimash Kukës, si dhe gjithë punonjësve të industrisë minerare në Shqipëri.
Gjatë vitit 2024-2025 sektori minerar në zonën min-

erare Bulqizë-Klos ka punuar në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të kromit duke prodhuar mineral kromi të pasur me cilësi 32-42% Cr₂O₃ për eksport si dhe mineral të varfër për furnizimin me lëndë të parë të disa fabrikave të pasurimit të kromit në Bulqizë, Batër, Krastë, Tërnove, Kalimash etj...

Ing. Bukurosh KOÇI

